

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7690 E premte 26 Tetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga GERON KAMBERI

Negociatat Shqipëri-BE për anëtarësim: Beteja me kohën



Procesi i negociatave për anëtarësim për në BE përfaqëson një periudhë kohore, në të cilën vendi kandidat dhe strukturat e Komisionit Europian ...
Vijon në faqen 20

Mesazhi

Ditës

Nga DANIEL KOSKI

Ministre Gjonaj, kolegë të trupit diplomatik, të ftuar të nderuar, të diplomuar. Është nder që jam sot me ju. Në emër të Qeverisë së Shteteve të ...
Vijon në faqen 21

SHBA i refuzon vizat për zyrtarët e korruptuar



SHBA: Kujdes nga mashtrimet në internet

Ambasada: Lotaria, udhëzimi si duhet të plotësoni formularin pa rrezikuar gabime

Konsullata shpjegon procedurat: S'keni nevojë të paguani dikë për regjistrimin

VOLTIZA DURO

Të gjithë ata që dëshirojnë të jetojnë e punojnë në tokën e premtuar kanë mundësinë të aplikojë për Lotarinë Amerikane deri në 6 nëntor. Ditën e djeshme, ambasada amerikane në Tiranë, i ka bërë thirrje të interesuarve ...
Në faqen 10

BISEDAT E KRYEBASHKIAKUT TE DURRESIT 2 DITE PAS ZGJEDHJEVE ME GRUPIN E SHIJAKUT

PERGJIMET: THUAJI VANGJUSHIT TE JAPE NAI LEK' TE VOTOJNE

Dialogu i të arrestuarit Altin Avdyli, kërkohet që të paguhet 6 votues. Reagimi i Dakos për përgjimet: Kam folur me Niçen, i kam duart "akullore"



(Në foto) Kryebashkiaku i Durrësit, Vangjush Dako. Faksimile e përgjimeve

OPERACIONI
I dënuari me 16 vite burg për pedofili, pranga në Tiranë italianit 45-vjeçar

Në faqen 9

EKSPERTI I EKONOMISE
Mateo Spaho: Mbyllja e lojërave të fatit ka pasoja të rrezikshme

Në faqen 11

INTERVISTA
Persida Asllani, një rrëfim për koleksionin e rrallë në vitet 1493-1940

Në faqen 18

REGJISORI
Petri Bozo: Çfarë nuk dini për fituesen kineze të "Miss Globe 2018"

Në faqen 13

NGJARJA NE MBREMJE



Breshëri plumbash, plagoset në atentat 50-vjeçari në Kamëz, dyshimi: Hasmëria

Në faqen 8

Kuvend/ Rrëzohet dekreti i Metës për shembjen e Teatrit, Majko nuk voton

Mbyllen bastet, PS: Ja sms-të kërcënuese

Rama: Do të ndalojmë alkoolin për fëmijë. Ahmetaj: Zgjidhje për të papunët

NGA VALENTINA MADANI

Mazhoranca qeverisëse i dha fund dje me votë bixhozit duke ndaluar me ligj bastet sportive. Pa opozitë, deputetët e mazhorancës miratuan me 75 vota projektligjin për mbylljen e lojërave të fatit. Me një votë



më pak u rrëzua dhe dekreti i Presidentit, duke i hapur rrugë ligjit për ndërtimin e Teatrit të ri. Ashtu si në dy herët e tjera ku pati dhe përplasja me kryeministrin Edi Rama, Pandeli Majko nuk mori pjesë në këtë votim. Ligji që mbyll lojërat e fatit dhe bastet sportive ...
Në faqen 4-5

SKANDALI I PERGJIMEVE KRYEBASHKIAKU

Kryebashkiaku i Durrësit: Jam njeri me reputacion, nuk i shoh njerëzit nga diploma

"Alibia" e Dakos: Flas me njerëz që janë të famshëm në familjet e tyre

"Përgjimi? I kam duart akullore, jo me gjak"

Kreu i Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako ishte i ftuar në emisionin 'Opinion' teksa deklaroi se nuk ka bir ku*ve që komunikojnë me telefon më shumë se ai. Dako është indinjuar lidhur me akuzat dhe dokumentet e dala nga përgjimet e prokurorisë së ai ka komunikuar me anëtarë të Avdyllave.

Dako tha se është një nga njerëzit që komunikojnë më shumë me qytetarët për hir të punës së tij si kryetar i Bashkisë së Durrësit.

Keni folur me këta persona?

Unë jam kryetar i bashkisë dhe jam i zgjedhur me votë, për të marrë votën unë komunikoj me të gjithë votuesit. Unë komunikoj me të gjitha njerëzit që janë të famshëm në familjet e tyre, të cilët mund të marrin vota. Unë marr emrat e zgjedhësve dhe u marr kontaktet për t'u marrë votën, në shërbim të punës që unë do të bëj. Unë flas për veten time, i njej ata prej kohësh të gjithë qytetarët e Durrësit.

Pse nuk e dini se me kë flisni?

Unë kur kërkoj votat nuk shikoj as diplomat dhe as dëshminë e penaltetit. Unë jam i bindur se kam zgjedhur. S'ka bir kurve që të ma marr mua, me të folur me telefon me qytetarët Durrësit. Me mesazhe mund të ma marrë vetëm Rama, por për telefonata jo.

"I KAM DUART AKULLORE"

Kreu i Bashkisë së Durrësit tha në lidhje me pastërtinë e figurës së tij nuk mund të flasë askush për shkak të punës dhe reputacionit të tij.

Dako shkëputi një metaforë për ta ilustruar këtë, duke u shprehur se është një akullore dhe duart e tij janë të pastra dhe jo si kreu i PD-së Lulzim Basha që i ka të zeza dhe me gjak.

"Nuk mund të dalë kreu i opozitës dhe të thotë të arrestohet kreu i Bashkisë së

Durrësit, unë jam njeri dhe kam ndjenja, por mbi të gjitha kam dhe familje. Unë jam njeri me reputacion jo vetëm në Durrës, por në të

gjithë Shqipërinë. Unë jam akullore, duart e mia janë akullore të pastra dhe jo si kreu i opozitës që i ka me gjak dhe të zeza",-tha Dako.

DOREHEQJE?

Dako u shpreh se nuk ka pse të japë dorëheqjen deri sa hetimi, në rast se do të nisë, të nxjerr nëse është i pafajshëm apo jo kryebashkiaku i Durrësit. "Do vazhdoj të jem kryetar, pse do jap dorëheqjen. Akuzat nuk është asgjë. Nëse gjykata të fut në burg, ti automatikisht ikën nga kryetar bashkie." u shpreh Dako. Ndër të tjera Dako iu përgjigj edhe pyetjes në rast të një kandidimi në zgjedhjet e ardhshme vendore. "Unë nuk ndihem i lodhur, janë strukturat që vendosin për kandidimin apo jo në zgjedhje, por mund ta shoh veten edhe në një post tjetër, përveç atij të kreut të Bashkisë. Unë përsëri do të drejtoj fushatën në të tri Bashkitë e Durrësit, Krujë, Shijak dhe Durrës dhe të garantoj të tria janë të fituara",- u shpreh Vangjush Dako, i ftuar në emisionin 'Opinion'.



Kreu i Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako

Andi Bushati: Prokuroria me 2 standarde për Dakon e Çukon

Analisti Andi Bushati, i ftuar në emisionin "Të Paekspozuarit", ku u publikua një transkript i bisedës së Vangjush Dakos me një prej anëtarëve të bandës Avdyli, u shpreh se publiku e ka të qartë se Vangjush Dako komunikojnë me anëtarët e bandës dhe se ai është pjesë e përgjimeve në dosjen 339. Bushati tha se prokuroria ka vepruar me dy standarde, ka kërkuar burg për Arben Çukon në bazë të një përgjimi, dhe lë të lirë Vangjush Dakon, megjithëse edhe për të ekziston një përgjim.

"Ne sot kemi një lajm. Ka pasur një debat publik për 2 vjet me radhë. Njëra palë thoshte në përgjime gjermane dhe shqiptare, me bandën del i lidhur Dako. Dako shkoi në gjyq



dhe tha do çoj Bashën në gjyq.

Me këto dokumente kemi lajmin e parë. Vangjush Dako, komunikojnë me pjesëtarët e prezumuar të bandës. Lajmi i dytë, Vangjush Dako rezultoi në përgjimet e të akuzuara, si anëtar të një bande kriminale që bënte trafik, si një njeri

që përmendet për të folur për zgjedhjet. Po të shohësh datat e dokumenteve që kemi në dispozicion, janë 24 dhe 27 qershor.

Në 24 qershor, flitet çfarë do bëjmë për të paguar njerëzit për zgjedhje. Dhe në 27 flitet çfarë do bëjmë për t'i falënderuar njerëzit

A mund të bërtasim, siç bërtet opozita, që Dako duhet të shkojë në burg? Absolutisht jo. Por, që kur prokurorinë e ka marrë në dorë Arta Marku, po na ndodh një gjë, çështjet që prekjin pushtetin, arkivohen. Edhe në këtë dosje, sa ka dalë Vangjush Dako, është hapur ajo 339 dhe pastaj 339/1. Njëllor si me vëllain e ministrit të brendshëm. Dosjet e njerëzve që prekjin pushtetin, arkivohen."



Dje në emisionin "Të paekspozuarit" në "News 24"

OPERACIONI "VOL-VO 4"

EMRAT QE U LANE NE BURG

- 1.HAJRI SEFERI
- 2.JASIN KALA (ALIAS JASIN AVDYLI)
- 3.SHKELQIM AVDYLI
- 4.ASTRIT AVDYLI (ALIAS SULEJMANI)
- 5.SAIMIR GJEPALI
- 6.ALTIN AVDYLI
- 7.JASIN AVDYLI
- 8.FATOS LLAFTIU
- 9.DENIS LLAFTIU
- 10.ESAT MEHMETI
- 11.SAIMIR SULEJMANI
- 12.ELIS GURI
- 13.ILIRJAN PRIFTI
- 14.PETRO KUCI (ALIAS ABEDIN KUCI)
- 15.ARDIT GJYRIQI
- 16.ELTON SHEHAJ
- 17.ARMAND SPIRO
- 18.ARBEN CUKO
- 19.ZEF LAZRI
- 20.ARTUR BALLA
- 21.ARBEN NDOKA
- 22.GJEVI NDOKA (ALIAS XHEVAIR)
- 23.BLEDI NDOKAJ
- 24.PAULIN SIMONI
- 25.ZEF LAZRI

NE "ARREST SHTEPIE"

- 1.Bledar Koci (arrest shtëpie)
- 2.Lule Zeneli (arrest shtëpie)
- 3.Luigj Paloka (arrest shtëpie)
- 4.Kol Lleshi (arrest shtëpie)
- 5.Vlasi Gazulli (arrest shtëpie)
- 6.Zef Ndoka (arrest shtëpie)
- 7.Vasil Nika (arrest shtëpie)
- 8.Genc Zeneli (arrest shtëpie)

DETYRIM PARAQITJE

- 1.Mimoza Ndoka (detyrim paraqitje)
- 2.Marjeta Perskura (detyrim paraqitje)



Përgjimet/ "Niçja" flet në telefon: Thuaji Vangjushit t'i japë nai lek të votojnë

Biseda e Dakos me grupin e Shijakut pas zgjedhjeve: Doja ta falënderoja Astritin

Kryebashkiaku flet në telefon me të arrestuarin Altin Avdylaj

TIRANË

Emisioni "Të paekspozuarit" në "News24" ka sjellë mbrëmë një bisedë të zhvilluar mes kryetarit të Bashkisë së Durrësit Vangjush Dako me Altin Avdylaj (Niçja) një prej personave të arrestuar gjatë operacionit "Vol-Vo 4" dhe të akuzuar si pjesë e grupit shijë të narkotikëve, "Trafikim i narkotikëve", në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal dhe organizatë kriminale, si dhe pastrim i produkteve të veprës penale.

Biseda është zhvilluar dy ditë pas zgjedhjeve të përgjithshme të 25 qershorit të fituara nga Partia Socialiste. Në bisedën e përgjuar, ku Altin Avdylaj identifikohet si Niçja ndërsa Dako vetëm me numrin e telefonit, kryetari i Bashkisë së Durrësit falënderon Avdylajn dhe i kërkon të takohet.


DY BISEDAT E PERG-JUARA

Biseda e parë është zhvilluar më datë 27 qershor në orën 11:08 të paradites ku thirrja bëhet nga numri 069 20 99 300 drejt numrit 069 89 67 XXX dhe zgjat 1 minutë e 3 sekonda. Biseda mes Avdylaj dhe Dakos është zbardhur më 23 tetor 2017. Në dokumentin e Prokurorisë së Përgjithshme thuhet, gjithashtu, se personi që përdor telefonin e përgjuar është pikërisht numri 069 20 99 300 që i përket kryetarit të Bashkisë së Durrësit Vangjush Dako.


Biseda e dytë është bërë mes Altin Avdylajt dhe një personi tjetër që i kërkon t'i thotë Dakos të paguajë një familje që ka votuar për ta në zgjedhje.

BISEDAT E PARË

Niçja: He kryetar, he vllai. 0692099300: Niçe, ku je? Niçja: Këtu vërdallë... 0692099300: Ku është Astriti? Niçja: Ka lëviz një çikë. 0692099300: Ku ka lëviz? Jashtë Durrësit? Niçja: Eh... çka ka? Ka ndonjë gjë? 0692099300: Po jo mo, doja ta takojsha, ta falënderojsha, ta pyesja një çikë. Niçja: Po, po ku je ti? Të vij të të takoj... Njësoj është, si ai si unë, e di që jemi një



Faksimile nga përgjimi i Dakos



KRYETARI I PD



A iku shefi i SHISH-it për dosjen "Dako"? Përgjigjet Basha

TIRANË. Në një lidhje direkte për emisionin "Të Paekspozuarit" në News24, kreu i PD, Lulzim Basha është pyetur për përgjimet mes kreut të bashkisë së Durrësit Vangjush Dako me anëtarë të bandës së Avdylajve si dhe deklaratat e tij të bëra para një viti se largimi i ish kreut të SHISH, Visho Ajazi Lika kish të lidhje me këtë ceshtje. "Unë nuk vendos në rrezik jetën e njerëzve për burimet e mija. Denoncimet dhe informacionet i mbledh me mënyra të ndryshme dhe i bëj publike me pas vlerësim-it. Pak rëndësi ka nëse kjo ka qenë pika e fundit e gotës që ka çuar në largimin e ish kreut të SHISH, Visho Ajazi Lika. Sot Edi Rama nuk ka asnjë hallkë të shtetit jashtë kontrollit të tij. Kjo është alarmante sepse kontrollon çdo gjë me dorë të hekur. Të gjitha këto tregojnë se Kuvendi është shndërruar në një dele të bindur. Kamikazja Donika Prela po shkatërron dosjet hetimore."- tha Basha.

LEVIZJET E PROKURORISË
Në emisionin "Të Paekspozuarit", u transmetua një kronikë, e cila rendit në mënyrë kronologjike se si dosja 339, ka kaluar nga njëri prokuror në tjetrin. Në mënyrë të çuditshme dhe të dyshimtë, kjo dosje ka kaluar në disa prokurorë. Si fillim atë e kishte Anton Martini, por ai transferohet në Shkodër nga Adriatik Lalla. Dosja merret nga Besim Hajdarmataj, i cili sërisht transferohet në një tjetër qytet, konkretisht në Pogradec, nga kryeprokurorja Arta Marku. Në fund dosja, përfundon në duart e Vladimir Marës dhe Dritan Prenci, të cilët e finalizuan për një kohë të shkurtër.

0692099300: Po mirë mo mirë, por doja ta takoj... kanë pi ato.
Niçja: Po, e di po, kanë lëviz... Me të taku një çikë unë ty!

0692099300: Unë tani jam duke ardh nga... rrugës... rrugës...
BISEDAT E DYTË
Biseda e dytë është bërë

nga numri i telefonit 069 56 39 642 (i paidentifikuar) drejt numrit 0898967XXX (Altin Avdylaj) në orën 20:06 të mbrëmjes me kohëzgjatje 31 sekonda një ditë para

zgjedhjeve të 25 qershorit. Niçja: Të marr unë se jam me rob pra... Alo, çka po bën? Niçja: Të marr unë se jam me rob të thashë! Ku je? Je andej nga fshatrat, ku ishe? Jo! Jo! Jo! Kam ca me mbiemër Kurti, kam zonjën këtu... po deshe... Niçja: ...mirë... 6 veta janë! Niçja: Hajt se të marr unë! Thuaj Vangjushit t'i japim ndonjë lek, që të votojnë!

Dosje të veçantë për Dakon?/ Prokuroria: Hetimi u bashkua



Këshilltari për Mediat i Prokurorisë së Përgjithshme, Denion Ndrejka
procedimi është ndarë në vitin 2017, por është bashkuar më 18 tetor. "Procedimi është ndarë në maj të vitit 2017. Tani prokuroria i ka bashkuar procedimet më 18 tetor 2018 në një hetim", ka thënë

Ndrejka. Emisioni "Të Paekspozuarit" në News24 ka publikuar mbrëmë bisedat që zhvillon kryebashkiaku i Durrësit Vangjush Dako me pjesëtarë të bandës së Avdylajve pak ditë para dhe pas zgjedhjeve të 25 qershorit 2017. Në emision janë treguar dy nga mbi 20 bisedat që mendohet se janë në dosjen e prokurorisë që mban numrin 339. Nga ana tjetër Dako ka pranuar se ka folur me të gjithë për shkak të fushatës, por duke mohuar akuzat për blerje votash.

KUVENDI MIRATIMI

Mazhoranca rrëzon dekretin e Metës për Teatrin, Majko për herë të tretë nuk voton

Valentina Madani

Mazhoranca qeverisë i dha fund dhe me votë bixhozit duke ndaluar me ligj bastet sportive. Pa opozitë, deputetët e mazhorancës miratuan me 75 vota projektligjin për mbylljen e lojërave të fatit. Me një votë më pak u rrëzua dhe dekreti i Presidentit, duke i hapur rrugë ligjit për ndërtimin e Teatrit të ri. Ashtu si në dy herë të tjera ku pati dhe përplasje me kryeministrin Edi Rama, Pandeli Majko nuk mori pjesë në këtë votim. Ligji që mbyll lojërat e fatit dhe bastet sportive, hyn në fuqi më 31 dhjetor.

MESAZHET
Në seancën parlamentare të votimit për mbylljen e basteve dhe zhvendosjen e kazinove larg qyteteve, socialisti Erion Braçe tregoi përmbajtjen e mesazheve kërcënuese që ai dhe deputetët e tjerë të Komisionit të Ekonomisë kanë marrë këto ditë. Braçe deklaroi nga foltorja e Kuvendit se ka marrë mesazhe kërcënuese edhe për fëmijët. "Ti dhe ju u keni hequr bukën fëmijëve tanë, ne do merremi me fëmijët tuaj". Ky mesazh standard ka ardhur në celularin tim dhe të kolegëve, pothuajse e dërguar nga një dorë. Kush nga ju mendon se jemi të dobët po mendoni gabim. Nuk na paskeni njohur, ne nuk heqim dorë nga betejat tona. "Nuk e votoni dot ligjin, nuk e bëni dot, ja do ta shihni", ka patur prapë mesazhe të tjera. "Nuk na keni njohur. Do e votojmë se s'bën", deklaroi Braçe.

TEATRI
Mazhoranca votoi dhe kundër dekretit të Presidentit Ilir Meta, i cili kthehu për shqyrtim ligjin që i hap rrugë shembjes së godinës ekzistuese të Teatrit dhe ndërtimit të një godine të re. Edhe këtë herë ajo që ra në sy ishte mungesa e votës nga Pandeli Majko. Ministri i Diasporës si në dy herë të para ka preferuar që të mos votojë, duke shprehur kundërshtinë e tij me mazhorancës. "74 vota kundër; 1 nuk mori pjesë në votim, rrëzohet dekreti i Presidentit për Teatrin", tha Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi. Në votim nuk mori pjesë ministri i Diasporës, Pandeli Majko. Në këtë mënyrë, socialistët i hapin rrugën një gare për ndërtimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar në të njëjtin vend ku aktualisht ngrihet teatri ekzistues. Në këtë mënyrë, socialistët i hapin rrugën një gare për ndërtimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar në të njëjtin vend ku aktualisht ngrihet teatri ekzistues.

Fundi i bixhozit, zbardhen sms kërcënuese: Do merremi me fëmijët tuaj

Braçe publikon mesazhet: S'na keni njohur



Deputeti i PS-së, Erion Braçe

AQIF RAKIPI

Ish-deputeti i PDIU-së, Aqif Rakipi kërkon rikthimin në politikë dhe aktivizimin në fushatë. Rakipi ka paditur Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në Gjykatën Administrative për ndërprerjen e mandatit. Padia e ish-deputetit është regjistruar si çështje në datën 7 shtator.



Gjikhuri: Së shpejti projektligji i plotë për statusin e minorëve

Ministri i Energjisë dhe Infrastrukturës premtoi dhe Financave do të hartojnë një projektligji të plotë për statusin e minorëve. Në interpelancën që pati me një përfaqësi banorësh dhe minorësh në zonën e Pogradecit, Përrenjasit dhe Librazhdit mbi politikën e qeverisë mbi nxitjen e industrisë përpunuese, Gjikhuri tha se aktualisht ka një draft në Ministrinë e Financave për çështjen e statusit. Ai deklaroi se në përfundim statusi do të jetë për të gjitha kategoritë dhe jo i ndarë në grupe. "Sot që flasim ky draft ndodhet në Ministrinë e Financave dhe së fundmi së bashku me këtë ministri duam të bëjmë një draft me një projektligji të konsoliduar në mënyrë që të kemi një zgjidhje të përgjithshme dhe një zgjidhje të pjesshme, ku ngrihet një grup dhe kërkon një privilegj, një trajtim të posaçëm për shkak të profesionit që ka", deklaroi z.Gjikhuri. Duke iu përgjigjur interesit të minorëve për investimet në nxjerrjen e ferro-nikelit Gjikhuri foli për projekte konkrete. "Ne jemi duke parë edhe disa propozime të fundit në lidhje me ringjalljen e industrisë së ferro-nikelit në të gjithë zonën", u shpreh ministri Gjikhuri.

NISMA

Pas nismës për heqjen e kazinove dhe basteve, qeveria prezantoi dhe në Kuvend një nismë për kufizimin e tregimit të pijeve energjike dhe pijeve të gazuara me

sheqer të shtuar për personat nën 18 vjeç. Deputeti socialist Erion Braçe tha nga foltorja e Kuvendit se do të kufizohet edhe reklamimi agresiv për këto produkte. Sipas mazhorancës, jo

Balla: 92% e grave, pro mbylljes së basteve

Gjatë një takimi të zhvilluar pasditen e djeshme në qytetin e Elbasanit me gra dhe vajza të këtij qyteti, kreu i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla deklaroi se 92% e grave e kanë mbështetur nisimën për mbylljen e pikave të basteve dhe lojërave të fatit. "E vërteta është që 92% e grave dhe nënave e kanë mbështetur këtë vendim që kemi marrë sot. Vëmendja jonë është tek familja dhe e kemi pasur këtë kërkesë prej pjesës më të madhe të grave dhe nënave, për t'i dhënë fund kësaj mortje. Në fakt, funksionimi i këtyre lojërave të fatit na kishte shkatërruar vit pas viti me dhjetëra e mijëra familje", u shpreh Balla.




Seanca e djeshme parlamentare

BORCHARDT
"Jemi të angazhuar në procesin e reformës zgjedhore. Kemi një bazë të themele për diskutim. Jemi në rrugë të mirë. Kjo është në dorë të shqiptarëve për të vendosur. Por është një bazë e sofistikuar për diskutim, e cila mund të përmirësohet. Dhe kjo ka nevojë për një diskutim të gjerë, si p.sh kishte diçka që më pëlqen shumë, rregulli i barazisë gjinore. Procesi i apelit i rekomanduar nga ne nuk është bërë. Kërkojmë me ngulm që të bëhet", - tha Borchardt.

Mbyllja e basteve, Ahmetaj: Zgjidhja për të papunët pas 1 janarit

Ministri i Financave, Arben Ahmetaj, gjatë fjalës së tij në Kuvend, tha se vendimi i kryeministrit për të mbyllur të gjitha pikat e basteve, është një vendim i maturuar. Ai shpjegoi dhe se çfarë do të ndodhë me 7200 personat e punësuar në këtë industri, pas mbylljes më 1 janar 2019. "Ka tre elementë që kemi menduar. Jemi duke përgatitur një platformë trajnimit për 63 mijë punëkërkuar. Trajnimi do të jetë profesional, por edhe mundësi për të kërkuar më shpejt dhe më zgjuar punë dhe për paraqitje dinjitoze në punëkërkuarshmëri. Programi tjetër është trajnimi profesional, deri më sot kemi trajnuar 10 mijë persona,



vitin tjetër do të trajnojmë 20 mijë punëkërkuar. Mbyllja e kësaj industrie do të jetë një çlirim i madh social. Në 1 janar asnjë qytetari nuk do t'i mungojnë pikat e basteve që janë kthyer në gangrenë familjare. Në ligj kemi shtuar edhe dy elemente, shtesa e parë është përgjegësia e shtetit për monitorim dhe ndërmjetësim. E dyta janë reklamim, ndalimi i tyre", tha z.Ahmetaj. Sipas tij s'ka më asnjë ekuivok dhe 1 janari është një epokë e re sociale dhe në këtë industri. "Po ato para që janë shpenzuar në këtë sektor, ku shkojnë? Në aspektin ekonomik është joproduktiv. Ato 10 lekë apo më shumë, që shpenzoheshin në lojërat fati do shkojnë për konsum... konsum për arsim, shëndetësi, argëtim, hotele, restorante, etj. Vendimi i kryeministrit për t'i mbyllur është e maturuar. Nuk ka kthim pas.", tha Arben Ahmetaj.

nismë do t'i bëjë mirë shëndetit të njerëzve dhe shëndetit të financave të tyre. "Kërkoj mbështetjen e kolegëve për të vendosur kufizime në tregtimin dhe konsumimin e pijeve en-

ergjike për fëmijët deri në moshën 18-vjeç. Ndëshkrim për të gjithë madhorët, që u ofrojnë fëmijëve pijeve energjike marrë nga dyqanet. Kufizimet vijojnë me ata që i tregojnë brenda klubeve apo

koktejlle, të ndaluar për fëmijët. Kufizime të forta edhe për reklamim dhe kompanive agresive, drejtuar fëmijëve për të konsumuar pijeve energjike me sheqer të shtuar", - deklaroi z.Braçe.



VIZITA

Kryeministri izraelit, Benjamin Netanyahu do të zhvillojë një vizitë zyrtare në Shqipëri më 1 nëntor, ku do të takohet me krerët e lartë të vendit dhe do të jetë i pranishëm në një samit rajonal. Vizita në Shqipëri është pjesë e turit ballkanik të Netanyahu, i cili sipas zyrës së tij të shtypit do të ndalet gjithashtu edhe në Greqi, Bullgari, Rumania dhe Serbi.

**Integrimi, ambasadori i BE:
Duhet të ketë konsensus**

Një muaj pas nisjes së detyrës, ambasadori i Bashkimit Evropian, Luigi Soreca shprehet se Shqipëria është në një moment delikat. Në takimin e Komitetit të Stabilizimit Asociativ në Ministrinë e Jashtme, ai u kërkoi të gjithë faktorëve politikë të bashkëpunojnë. "Duhet konsensus. Është shumë e rëndësishme që të gjithë aktorët të jenë të bashkuar, pasi Shqipëria është në një moment që po vendos për të ardhmen e saj", deklaroi z.Soreca. Nga ministrinë kërkoi vazhdimin e reformës në administratë. "Pas pasur një administratë të fortë dhe të aftë, vendi nuk ka mundësi të bëjë përpjekje qoftë në aspektin afatgjatë apo afatshkurtër", u shpreh ambasadori Soreca. Përfaqësues të qeverisë shqiptare gjatë këtij takimi shprehën vullnetin për plotësimin e prioritetve, në veçanti për reformën në drejtësi, që i hap rrugë integrimit të vendit drejt BE.

**Ambasadori austriak: Opozita në
Kuvend, vetingu i rëndësishëm**

Ambasadori i Austrisë, Johan Sattler apelon opozitën t'i japë fund bojkotit dhe të rikthehet në parlament, si vendi ku sipas tij bëhet debati politik. Nga Shkodra, përfaqësuesi i Vjenës tha se vetingu i politikanëve është i rëndësishëm, por sipas tij, atë do ta bëjnë institucionet reja të drejtësisë. Duke iu referuar aksioneve kundër të ashtuquajturve të "Fortët", Sattler kujtoi termin e "peshkut të madh", të ambasadorit amerikan, Donald Lu, që tashmë është larguar nga vendi. "Peshku i madh", njeriu që e shpiku këtë term nuk është më në Shqipëri. Por ajo që kemi parë muajt e fundit është një hap pozitiv, sepse ka përqendrim për të dërguar pas hekurave të fortët. Vendi i të gjithë përfaqësuesve të zgjedhur të popullit është parlamenti. Nga kontaktet me përfaqësuesit politikë të të gjitha palëve, e kam shprehur që debati politik duhet të ndodhë në parlament. Jam optimist se mund ta arrijmë këtë dhe mund të kemi zgjidhje të situatës", tha Sattler. Vetingu në politikë është kushti i shprehur i opozitës për t'u rikthyer normalitetit në Kuvend. "Vetingu i politikanëve është shumë i rëndësishëm dhe do të ndodhë pasi të kemi institucionet që kërkojnë pak durim, sepse vitin tjetër do të kemi Byronë Kombëtare të Hetimit dhe SPAK, që është i dizenuar për këtë punë", tha Sattler.

Kryeministri: Në vitin 2009 u hapën burgjet. Kriminelët, fushatë në krah të ministrave

**Pas basteve, Rama: Ndalimi i
alkoolit për fëmijët në lokale**

"Skllavja 'Izaura' dhe 'Ezeli' në versionin Luli dhe Mona"

Më votat e të gjithë deputetëve të mazhorancës, parlamenti miratoi djë mbylljen e të gjitha pikave të basteve nga 1 janari i 2019. Vetëm pak minuta para këtij votimi, kryeministri Edi Rama e cilësoi vendimin si dëshmi e vullnetit për t'i dhënë fund një plage të tillë sociale, por edhe si një përgjigje për të gjithë ata që u pozicionuan kundër, përfshirë edhe njerëz të botës së krimit, që kërcënuan me SMS deputetët socialistë të Komisionit të Ekonomisë. Mungesën e opozitës në votimin e këtij ligji e quan marrëzi. Jo vetëm opozitës, por edhe mediave që e akuzuan se këtë vendim si dhe operacionet e fundit kundër rrjeteve të krimit të organizuar i cilësuan si 'show' për të tërhequr vëmendjen, ju kujton zgjedhjet e 2009. "Në vitin 2009 u hapën burgjet dhe u raportua nga Ambasada Amerikane në DASH. Dhjetëra kriminelë që u dha leje për të bërë punën që bëjnë. Në brenda PS-së kishim grupin e mbrojtjes së votës, që i mbronim nga presioni i madh i të inkrimnuarve, atyre që dolën nga burgjet dhe bënëin fushatë në krah të ministrave", deklaroi Rama.

IRONIA

Kryeministri Edi Rama iu përgjigji të gjithë atyre që e akuzojnë se lojërat e fatit po i ndalon për të hequr vëmendjen nga situata aktuale. Nga foltorja e Kuvendit, ai ironizoi opozitën, e cila nuk merr pjesë në Kuvend, duke i krahasuar Bashën dhe Kryemadhin me personazhet telenovelave "Ezeli" dhe "Skllavja Izaura". "Një bast do ta fitonte PD, kush shpif më shumë në njësinë e kohës. S'do kishte gola, s'do kishte korne, s'do kishte penallti as në Egjipt as në Malajzi, që do konkurronin gol, kornet e shpifjeve të PD. Po nga duam ta tërheqim vëmendjen, se nga është vëmendja? Nga Babalja, na iku Babalja nga ekrani. Nuk po e ndjek më populli me interes telenovelën, në momentin kur po bëhej gati të dilte një aktor tjetër. Nga 'Ezeli' i PD, nga 'Izaura' nga 'Skllavja Izaura' në versionin Luli dhe Mona. Nga këto po e tërheqim vëmendjen dhe po merremi me gjëra, që në fakt nuk janë ndonjë gjë e madhe", theksoi z.Rama.

KLIJENTË

Kryeministri Edi Rama bëri publike një fakt që deri tani nuk ishte publikuar për lojërat e fatit. Në Kuvend ai



Kryeministri Edi Rama

tha se në bashkitë e vogla, klientë të rregullt basteve janë personat me ndihmë ekonomike, por kjo tha kryeministri nuk do të tolerohet. "Pikat e basteve në qytetet më të vogla kanë si klientë të pandarë një numër të konsiderueshëm burrash apo djem nga familje me ndihmë ekonomike. Ndihmë ekonomike merret dhe hidhet në bixhoz. Kjo është arsyeja pse duhet të forcojmë ligjin për ndihmën ekonomike. Së pari, të garantojmë që s'ka burrë që prek ndihmën ekonomike. Ndihmën ekonomike do ta marrin gratë ta çojnë në shtëpi. Nga ana tjetër, duhet në ligj të garantojmë se pas mundësisë

së dytë për punë të refuzuar t'i e humbet ndihmën ekonomike dhe nuk mund të regjistrohesh si i papunë muajin e ardhshëm, por vitin e ardhshëm", deklaroi kryeministri.

KËRCËNIMET

Kryeministri Edi Rama iu dha një përgjigje personave që kanë kërcënuar deputetët e Komisionit të Ekonomisë, të cilët votuan amendamentet për ligjin e lojërave të fatit, duke i shpallur ato të jashtëligjshme. Rama gjatë fjalës së tij në parlament ka thënë se ata do të marrin përgjigjen e merituar me mbylljen e lotove dhe kazinovë si dhe me përgjigjen ligjore. "Respekt për të gjithë ata që kaluan një

periudhë stresi të veçantë me shumë SMS të llojeve të ndryshme dhe atyre që i kanë çuar ato SMS, që i kanë porositur nga jashtë apo brenda burgut iu jap një përgjigje tani me ndalimin e bixhozit dhe në vijim do u japim përgjigje të njëpasnjëshme, siç nuk i kanë parë në endrën e tyre më të keqe", u shpreh Rama. Me herët deputeti i PS-së, Erjon Braçe, lexoi një mesazh që i kishte ardhur nga persona të panjohur, ku thuhej se me mbylljen e lojërave të fatit po u hiqnin bukën e fëmijëve dhe se tashmë ata do merrshin me fëmijët e deputetëve.

BETEJA

Kryeministri Edi Rama paralajmëroi një tjetër betejë pas asaj për mbylljen e basteve dhe kazinovë. Bëhet fjalë për ndalimin e tregimit të alkoolit për të rinjtë nën 18 vjeç, si dhe ndalimin e hyrjes në lokale gjatë orarit të mësimt. Rama njofton një plan masash për këtë nisim ndaj lokaleve. "Tani radhën e ka beteja kundër tregimit të alkoolit për të rinjtë nën 18 vjeç dhe ndalimi i hyrjes në lokale për ta gjatë orareve të mësimt, të pashoqëruar me mesues apo prindër. Shumë shpejt plani i masave administrative për lokale që kapen në shkelje të këtyre dy rregullave", shkruan kryeministri Rama.

**Kufijtë, Meta në qendrën "Xhorxh
Marshall": Ndryshimi cenon sigurinë**

Presidenti i Republikës, Ilir Meta vizitoi qendrën europiane, "Xhorxh Marshall" në Garmish të Gjermanisë, si i ftuar nderi për të folur mbi çështjet e sigurisë dhe integrimit euroatlantik të Ballkanit. Një ndër temat për të cilat foli kreu i shtetit ishte Kosova, ku prerazi dhe qartë deklaroi se është kundër ndryshimit të kufijve, pasi kjo gjë do të cenonte sigurinë e rajonit. Duke iu referuar idesë së korrigjimit të kufijve, Meta tha se propozimi i fundit për një debat të ri mbi atë që do të përbënte marrëveshjen përfundimtare për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë, po konsu-



Presidenti i Republikës, Ilir Meta gjë në qendrën europiane, "Xhorxh Marshall" në Garmish të Gjermanisë

mon shumë energji për objektivat e gabuara. Presidenti Meta vlerësoi qendrën "Xhorxh Marshall", simbol të partneritetit strategjik amerikano-gjerman, e cila ka mirëpritur dhe ka specializuar me shumë se 800 pjesëmarrës nga Shqipëria

që në vitin 1993 e deri më sot. Kreu i shtetit theksoi se zgjerimi i NATO-s dhe kompaktësia e Bashkimit Europian kundrejt rajonit të Ballkanit Perëndimor mbeten kyç për stabilitetin dhe sigurinë e rajonit tonë.

ZGJEDHJET AKUZAT

'Teatri', kreu i PD: Do kenë përballë qytetarët, po pastrohen para të pista

Nismat e opozitës, Basha: Krimi i siguroi Ramës 15 mandate

"U dhanë miliona për mosarrestimin e Dakos"



DENONCIMI
Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje mesazhin e një "qytetari dixhital", sipas të cilit, Afrim Bakaj, drejtor i Portit Durrës dhe vëllai i tij, Altin Bakaj kanë bërë trafik të lëndëve narkotike me targa të falsifikuara. Sipas këtij të fundit, kjo bëhej në kohën kur Altin Bakaj ka qenë zv.drejtor i patentave në Durrës.

Kreu i PD-së, Lulzim Basha akuzoi dje kreun e qeverisë për lidhje të forta me kriminelët, që i kanë siguruar mandatet me kërcënime e dhunë. Në një dalje për mediat, z.Basha renditi bandat në qytete, që sipas tij i dhanë Ramës fitoren në 2017-ën, duke i siguruar 10-15 mandate. Basha tha se "peshku i madh" siç e ka pagëzuar ai kryebashkiakun e Durrësit, Vangjush Dako, do të duhej të ishte pas hekurave të burgut. "Pse nuk po arrestohet Dako, kush ka ndërhyrë, kush i ka bërë presion prokurorisë, apo hidhen miliona për të mos e arrestuar atë?", deklaroi z.Basha. Sipas tij, drejtësisë nuk po i dorëzohet, pasi ka mbrojtjen politike të kryeministrit Rama në këmbim të votave që u ka siguruar socialistëve në zgjedhje përmes bandës së Avdyllajve, të arrestuar në operacionin "Vol-vo". "Dako është qartësisht një nga personat kyç të bashkëpunimit me Avdyllajt dhe me të tjerët të krimit të organizuar në Durrës, ku në këmbim të mbështetjes për vota, ky të japë tendera e favore, të ndikojë që të mos i hyjë asnjë gjemb në këmbë, madje kush është në burg të lirohet si bëri me Lulzim Berishën", u shpreh kreu i PD-së. E njëjta skemë sipas tij është ndjekur nga kryeministri në të gjithë vendin, ku përmes lidhjeve me bandat e kriminelëve, Rama ka siguruar mandate përmes kërcënimit, blerjes e dhunës. Sipas Bashës, krimi i ka dhënë 10-15 mandate Ramës. "Në përgjimet e Lezhës është e njëjta gjë. Ndokan kanë qenë bandë elektorale e PS-së. Në Kavajë del qartë se Elvis Roshi ka bërë të njëjtën gjë, së bashku me Gent Dajën. Madje, aty krimi dhe pushteti edhe formalisht u shkri në një në personin e Elvis Roshit. Në Elbasan Qazim Sejdimi ka bërë të njëjtën gjë. Njësoj në Dibër, Prokuroria ka një dosje tjetër ku hetohet për vjedhjen e votave në Dibër ku është përfshirë Ulsi Manja, Damian Gjikhuri, Saimir Tahiri. Sot mund të themi me siguri se krimi i ka siguruar Edi Ramës të paktën 10-15 deputetë përmes kërcënimit, grabitjes dhe blerjes së votës", theksoi z.Basha.

TEATRI

Mazhoranca në parlament rrezoi dekretin e presidentit për Teatrin Kombëtar, por kreu i opozitës e cilësoi atë vijën e kuqe, duke dalë në



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

Tabaku, Ramës: Votuat pro kompanisë së basteve, po forconi mafiozët

Deputetja demokrate, njëkohësisht nënkryetaria e Komisionit të Ekonomisë, Jorida Tabaku u përgjigj dje kryeministrit Edi Rama pas votimit nga mazhoranca të ndryshimeve të ligjit për lojërat e fatit. Në një status në "Facebook", Tabaku analizoi deklaratat e Ramës dhe thotë se akuzon se i njëjti kryeministër ka vazhduar t'u japë leje ndërtimi këtyre personave, që sot i akuzon si të lidhur me krimin e organizuar mu në mes të Tiranës, duke i ofruar edhe arkitektin e tij të preferuar. Deputetja e PD deklaroi se kjo luftë nuk është as morale, as religjioze dhe as me principe dhe se deputetët që para dy vitesh sollën kërkesën për shtyrjen e implementimit të Ligjit të Lojërave të Fatit me argumentimin që do mbylleshin vende pune, sot janë të parët që betohen me dorën në Bibël apo Kuran se bixhozi është i keq. "Në të vërtetë, ata mendojnë njësoj si dy vjet më parë, por me ndryshimin që para dy viteve u urdhëruan të votojnë pro kompanie të basteve, ndërsa sot janë urdhëruar të votojnë pro kompanisë së basteve", shkruan Tabaku. Ajo e krahason mbylljen e basteve me ndalimin e alkoolit në SHBA në vitet '30, duke i konsideruar ves të dëmshëm për njeriun, rezultati që prodhoi ishte kontrabanda e alkoolit dhe forcimin e familjeve mafioze si Xhenovezët, Lukezët dhe Al Kaponen.

krah të artistëve dhe qytetarëve kundër prishjes së godinës ekzistuese. Ai bëri të qartë se opozita do të jetë krah qytetarëve për të kundërshtuar prishjen e teatrit. Sipas Bashës, qeveria nuk ka përballë vetëm opozitën, por të gjithë qytetarët. "Unë, PD dhe

opozita e bashkuar e konsiderojmë këtë ligj jo vetëm antikushetues, por provën e qartë se si shteti, në këtë moment parlamenti, ka marrë krahun e grabitësve të pronës dhe kriminelëve që do pastrojnë paratë e pista të drogës. Përballë nuk kanë vetëm opozitën, vetëm ata

BOJKOTI

Opozita ka vendosur të mos plotësojë vendet vakante në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Aktualisht PD do të vijojë bojkotin e saj jo vetëm në punimet e parlamentit, por edhe në propozimin e anëtarëve të KQZ-së.

'Teatri', Spaho: Ligjin e ankimojmë në Kushtetuese

Votimi, Bylykbashi: Palaçot që po vjedhin shqiptarët me ligj?

PD-ja paralajmëron ankimin në Gjykatën Kushtetuese të ligjit për Teatrin e ri Kombëtar. Kreu i grupit parlamentar të PD-së, Emond Spaho, theksoi se nuk kishte dyshime që ky ligj do të miratohej dhe shtoi se tani hapi i radhës i Partisë Demokratike do të jetë ankimi në Gjykatën Kushtetuese. "Tani që ka ligj, do e ankimojmë, sepse më parë nuk kishim se çfarë të ankimonim. Teatri është çështje e gjithë Tiranës. Do të bashkëpunojmë me artistët dhe qytetarët që të bashkohemi për të bërë një front qytetar. Nëse çdokush vjen, ne do ta bllokojmë qeverinë", deklaroi Spaho për "TCH". Kurse deputeti demokrat, Oerd Bylykbashi shkruan në "FB": "Parlamenti e votoi dhe miratoi dekretin, pra pranoi rrezimin e ligjit duke i pranuar të nënta arsyet e presidentit, pa kundërshtuar asnjë". "Palaçot që po vjedhin shqiptarët me ligj". Edi Rama amendoj në rrugë



PETRIT VASILI

"Kryeministri, skllav i votave të qelbura dhe i jashtëqijtjeve të krimit. Kakarisjet e gjelit të fikur të qeverisë, që këndon mbi kutërbimin e plehut të horrlëkut dhe ushqehet me jashtëqijtje e kriminik në dëgjon me kurrkush. Tani ai është provuar botërisht si një shëmirtirë politike e prodhuar nga shëmirtira elektorale", tha z.Vasili.

antikushetuese? Ligjin e rrezuar dhe ia çoi përsëri të njëjtën 'çorbë' presidentit për dekretim. Presidenti e ktheu përsëri ligjin me veto, duke nënvizuar se asnjë nga 9 arsyet e rrezimit herën e parë nuk ishte zgjidhur. Mazhoranca ka vendosur të rrezojë tashmë dekretin e presidentit e të miratojë ligjin që vjedh pronën publike, duke prishur Teatrin Kombëtar. Tani, meqë presidenti nuk

ka ndryshuar qëndrimin dhe thotë se të nënta arsyet e rrezimit të parë mbeten edhe në ligjin e ri, të vjen vetui pyetja: E kishte gabim mazhoranca herën e parë kur pranoi 9 arsyet e presidentit, apo e pati gabim herën e dytë kur rrezoi po të njëjtat nëntë arsye të presidentit? Përgjigja është shumë e thjeshtë: janë hajdutë dhe palaço në të njëjtën kohë", shprehet z.Basha.?

artistë artdashës, intelektualë, por përballë kanë dhe do të kenë të gjithë njerëzit. Ky është momenti ku ka arritur vendi. Kemi në një anë interesin publik, nga ana tjetër kemi interesat kriminale që përfaqësohen nga oligarkët, nga bandat e trafikut të drogës dhe de-

putetët e Ramës në parlament, një pjesë e mirë e tyre të ardhur me votat e kriminelëve dhe jo me votat e qytetarëve. Si ka mundësi që shteti me miliardë euro buxhet nuk paska para për teatër?! Kjo është një aferë korruptive dhe kriminale. Kështu e ka kapur për fty

shtetin, për të mbrojtur interesat, paratë dhe pushtetin e tij. Sot ky është në pushtet vetëm për t'u shërbyer atyre. Qëndrimi ynë është i qartë, ne do të kundërshtojmë në krah të qytetarëve dhe artistëve dhe padyshim teatri është vija e kuqe", theksoi z.Basha.

DIPLOMACIA TURKE

INTERVISTA

Ministri i Jashtëm i Turqisë: Marrëdhënie të përkryera, Erdogan vjen në Tiranë

"Vëllezër shqiptarë, mos i çoni fëmijët në shkollat e FETO-s"

Mevlüt Çavusoglu: Mos nxini të ardhmen e tyre

Ministri i jashtëm i Republikës së Turqisë, z. Mevlüt Çavusoglu, në një intervistë për emisionin "Diplomaticus" të gazetarit Erion Kaçorri në televizionin "News 24" flet për marrëdhëniet e shkëlqyera që ekzistojnë mes Shqipërisë dhe Turqisë, raportet historike mes dy vendeve, investimet turke, bashkëpunimin tregtar, diasporën shqiptare në Turqi, vizitën e pritshme të presidentit turk Erdogan në Tiranë, por edhe elementet e FETO-s në Shqipëri, organizatë që konsiderohet terroriste nga Ankara. Shefi i diplomacisë turke nënvizon se Turqia dhe Shqipëria kanë një histori të përbashkët, qytetërim të përbashkët, kulturë të përbashkët dhe se ato duhen mbajtur gjallë, duke ua transmetuar brezave të rinj.

Zoti ministër, është vizita juaj e parë zyrtare në Shqipëri. A i ka përmbushur ajo pritshmëritë tuaja dhe cilat janë rezultatet e saj?

Ne kemi lidhje të fuqishme me Shqipërinë, lidhje që i kanë rrënjët në histori. Gjatë kësaj vizite vlerësuam marrëdhëniet tona dhe si të mund t'i zhvillojmë më tej ato. Kemi një bashkëpunim shumë të ngushtë me ministrin e Punëve të Jashtme, vëllain tim, Ditmir Bushati. Kemi një bashkëpunim të ngushtë si në NATO, ashtu edhe në institucionet e tjera ndërkombëtare. Zhvillimi i mëtejshëm i marrëdhënieve ekonomike, kulturore, si dhe në fusha të ndryshme si arsimit, shëndetësisë etj. janë në fokusin tonë. Në Shqipëri kompanitë turke kanë investime serioze, me shifra të konsiderueshme. Do të vlerësojmë edhe mundësitë për rritjen e këtyre investimeve, për arrijtjen në një miliard dollarë të vëllimit tregtar midis të dy vendeve, do të përcaktojmë hapat që do të hedhim në të ardhmen në kuadrin e këtij procesi. Vizita ime në të njëjtën kohë ka edhe një karakter përgatitor për vizitën presidentit tonë. Në të ardhmen presidenti ynë dëshiron të vizitojë Shqipërinë.

Çfarë temash keni ngrihur me autoritetet shqiptare?

Ekonomia është një prej tyre, edhe tregtia, investimet e këtushme, situata e kompanive tona dhe çfarë mund të bëjmë në fushën e arsimit. Ju e dini se fondacioni "Maarif" ka marrë Universitetin e Nju Jorkut në Tiranë. Hapja e shkollave të reja, kompanitë tona kanë investime për të bërë për spital dhe në fushën e shëndetësisë. Në takimet tona trajtojmë edhe shumë çështje



Ministri i Jashtëm i Republikës së Turqisë, z. Mevlüt Çavusoglu

që u interesojnë të dyja vendet, por edhe më parë, që në periudhën osmane. Shtetasit tanë me origjinë shqiptare dhe miqtë tanë shqiptarë që jetojnë sot në Turqi kontribuojnë në zhvillimin e ekonomisë së Turqisë, kontribuojnë edhe në pasurimin e kulturës turke. Ata janë të pranishëm edhe në disiplinën e ndryshme të sportit turk. Ne jemi të lumtur që sportistë shqiptarë, jo vetëm ata që banojnë në Turqi, por edhe në Shqipëri, janë pjesë e ekipeve të ndryshme turke në futboll dhe në basketboll.

Si i shikoni marrëdhëniet diplomatike, historike dhe kulturore midis Turqisë dhe Shqipërisë?

Marrëdhëniet tona diplomatike janë në nivel të përkryer, nuk ka asnjë problem. Lidhjet tona kulturore mbështeten në histori. Shikojmë se me të vërtetë lidhjet kulturore midis Turqisë dhe Shqipërisë janë shumë të fuqishme. Edhe në periudhën osmane shqiptarët kanë pasur pozicione të rëndësishme që kanë orientuar politikën tona. Për shembull, ka pasur shumë vezirë me origjinë shqiptare. Edhe sot në Turqi ka shumë shtetas tanë me origjinë shqiptare. Ata kanë ardhur edhe më vonë dhe janë sistemuar në Turqi. Ka lidhje shumë serioze midis popujve tanë, kemi një histori të përbashkët, qytetërim të përbashkët, kulturë të përbashkët. Prandaj duhet t'i mbajmë të gjalla, t'ua transmetojmë brezave të rinj, duhet t'i fuqizojmë më tej ato.

Sa e rëndësishme është diaspora shqiptare e Turqisë në hartimin e strategjive politike turke për Shqipërinë, Kosovën dhe rajonin?

Shqiptarët që banojnë në Turqi kanë orientuar politikën, diplomacinë dhe ekonominë tonë jo vetëm pas

themelimit të Republikës së Turqisë, por edhe më parë, që në periudhën osmane. Shtetasit tanë me origjinë shqiptare dhe miqtë tanë shqiptarë që jetojnë sot në Turqi kontribuojnë në zhvillimin e ekonomisë së Turqisë, kontribuojnë edhe në pasurimin e kulturës turke. Ata janë të pranishëm edhe në disiplinën e ndryshme të sportit turk. Ne jemi të lumtur që sportistë shqiptarë, jo vetëm ata që banojnë në Turqi, por edhe në Shqipëri, janë pjesë e ekipeve të ndryshme turke në futboll dhe në basketboll.

Shqipëria doli një vend i varfër pas regjimit komunist dhe natyrisht investimet nga Turqia, një vend që konsiderohet si një aleat i ngushtë, janë të nevojshme. Cili është niveli aktual i bashkëpunimit ekonomik midis Turqisë dhe Shqipërisë?

Siç u shpreha edhe në fillim, marrëdhëniet tona ekonomike janë në nivel të mirë, por e dimë se potenciali i tanishëm nuk pasqyron plotësisht potencialin midis të dy vendeve. Vëllimi tregtar është 500 milionë dollarë, synojmë të arrijmë në një miliard dollarë. Këtë shifër mund ta arrijmë lehtësisht. Natyrisht, për këtë duhet të përditësojmë edhe Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë, kjo do të jetë në të mirë të të dyja vendeve. Gjithashtu, edhe investimet e kompanive turke në Shqipëri vazhdojnë të rriten, i kanë

kaluar 2,5 miliardë dollarë. Sa më shumë Shqipëria përmirëson klimën për investimet dhe sa më shumë forcohet siguria, aq më shumë edhe kompanitë tona i shtojnë investimet. Pas shembjes së regjimit komunist, Shqipëria ka hedhur hapa shumë seriozë për të reformuar vendin. Siguria për investimet është shumë e rëndësishme dhe duke u rritur kjo siguri, do të rriten edhe investimet tona. Edhe kur kanë probleme, kompanitë tona këto probleme mund t'ua përcjellin qetësisht autoriteteve shqiptare. Edhe ne me kolegët tanë shqiptarë diskutojmë për problemet e kompanive turke. Synimi ynë është fuqizimi i ekonomisë shqiptare, rritja e mëtejshme e investimeve tona dhe arritja e objektivave në tregtinë midis të dy vendeve.

Turqia është përballur së fundmi me një krizë serioze financiare si rezultat i tarifave shtesë amerikane dhe sanksionit e SHBA për dy ministra turq. A do të ndikojë kjo situatë në investimet turke në Shqipëri, siç është Aeroporti i Vlorës?

Ekonomia jonë është dinamike dhe e fuqishme. Sistemi ynë bankar është i fuqishëm, sistemi ynë financiar është i fuqishëm, asnjëherë nuk kemi shkelur disiplinën financiare. Po kështu, të fuqishme janë edhe rezervat e Bankës Qendrore. Kohët e fundit pati një agresion ekonomik ndaj Turqisë, sidomos pati sulme tepër seriozë përsa i përket kursit të këmbimit. Pati insti-

HOMOLOGËT

"Kemi një bashkëpunim shumë të ngushtë me ministrin e Punëve të Jashtme, vëllain tim Ditmir Bushati", tha kryediplomati turk.

tucione të tjera, edhe vende të ndryshme që e shfrytëzuan acarimin që patëm me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Veçanërisht për kursin e këmbimit pati ngritje dhe zbritje. Por, falë masave që morëm dhe fuqisë së sistemit tonë, ne mundësuam ekuilibrin dhe tani gjithçka po ecën në rrugë të mbarë. Natyrisht, që duke nxjerrë mësimë duhet të forcojmë më tej sistemin tonë. Vitin e kaluar rritja ekonomike ishte 7,4 për qind, në tremujorin e parë të këtij viti përsëri ishte 7,4 për qind, në tremujorin e dytë më shumë se 5 për qind. Mesatarja vjetore do të jetë 5 për qind. Eksportet tona rriten vazhdimisht, edhe prodhimi industrial vazhdon të rritet. Ka rritje edhe në investimet e huaja në Turqi. Ato që kaluan ish-in kripa kalimtare. Kemi kapërcyer shumë pengesa. Gjatë këtyre 16 viteve të fundit në rajonin tonë gjeografik ka pasur ngjarje të rënda, në Europë ka pasur krizë, shumë vende përreth nesh kanë pësuar goditje, ndërsa Turqia ka përparuar pa pasur shumë dëme. Ne do t'i kapërcëjmë vështirësitë dhe do të ecim më hapa të sigurt në rrugën tonë. Askush të mos shqetësohet për këtë.

Çfarë mund të na thoni në lidhje me shkallën dhe aktivitetin në Shqipëri të institucioneve të ndryshme, që lidhen me organizatën FETO, e cila konsiderohet terroriste nga Ankara?

Mendoj se të gjithë miqtë tanë shqiptarë e kanë parë se FETO është një organizatë e rrezikshme. Edhe në Turqi, ajo ka bërë tentativa të ndryshme. Ne e dimë shumë mirë se çfarë bëri ajo për të shtënë në dorë qeverinë dhe institucionet e zgjedhura me rrugë

demokratike. Vëllezërit tanë në Shqipëri i ndjekin zhvillimet në Turqi. Gjatë vitit 2016, kjo organizatë tradhtarë bëri një tentativë për grusht shteti, brenda një nate 251 shtetas tanë ranë dëshmorë. Pjesëtarët e kësaj organizate sulmuan popullin me tanke, avionë F 16, helikopterë, hapën zjarr kundër banorëve të pambrojtur. Lëshuan tanket mbi trupat e shtetasve tanë. Populli ynë, nën drejtimin e presidentit tonë, tregoi një shembull të madh guximi dhe heroizmi dhe shpartalloi puçin. Më shumë se 2200 vetë u plagosën rëndë. Mendoni çfarë nuk mund të bëjnë ata që hedhin bomba nga avioni kundër popullit, lëshojnë tanket, bombardojnë parlamentin. I jap këto shembuj për të theksuar se sa e rrezikshme është kjo organizatë. Anëtarët e saj janë kudo në botë, ata nuk janë vetëm, pas tyre qëndrojnë forca të tjera. Ata përbëjnë një kërcënim shumë serioz kudo ku ndodhen, jo vetëm në Turqi. Ne e përjetuam një situatë të tillë. Ka vende mike dhe vëllezër që po e përjetojnë tani atë proces, njerëzit e FETO-s kanë shtënë në dorë sistemin në ato vende. Duke përdorur institucionet arsimore, ata depërtojnë në institucionet shtetërore nëpërmjet fëmijëve që kanë përgatitur në shkollat e tyre. Ashtu siç vepruan në Turqi, ata të njëjtën gjë po bëjnë në Kirgiz, në vendet e Azisë Qendrore, në Pakistan në shumë vende të Afrikës dhe të Azisë. Edhe Ballkani është një objekt i rëndësishëm për ta. Prandaj prania e FETO-s në këtë rajon është një rrezik shumë serioz jo vetëm për Turqinë, por veçanërisht edhe për Shqipërinë. U bëj thirrje të gjithë miqtë dhe vëllezërit tanë shqiptarë që të mos u japin shanse atyre, të mos i dërgojnë fëmijët në shkollat e tyre. Mos mendoni se fëmijëve tuaj nuk mund t'u ndodhë gjë prej tyre. Të dërgoni fëmijët në shkollat e kontrolluara nga këta terroristë do të thotë të nxini të ardhmen e fëmijëve tuaj. Dëshiroj që nëpërmjet jush këtë thirrje t'ua përcjell të gjithë vëllezërvë dhe miqtë tanë në Shqipëri.

"Nga akti i ekspertimit mjeko-ligjor, rezulton se të riut i ka pushuar zemra"

"Enea Ftoi nuk vdiq nga dhuna fizike"

Avokati i Popullit mbyll hetimin për rastin e 27-vjeçarit

TIRANË

Pesë muaj pas vdekjes në ambientet e paraburgimit të Korçës së 27-vjeçarit Enea Ftoi, institucioni i Avokatit të Popullit ka bërë me dije se ndaj të riut nuk është ushtruar dhunë. Ky ka qenë përfundimi i hetimeve administrative nga ana e institucionit në fjalë, ndërkohë që familjarët e tij akuzuan për dhunë policët.

Nga hetimet e AP-së, thuhet se 27-vjeçarit i ka pushuar zemra.

"Ndaj Enea Ftoi nuk është ushtruar dhunë fizike. Janë respektuar të drejtat ligjore gjatë veprimeve të kryera nga policia lidhur me orën e arrestimit, sigurimin e mbrojtësit, njohja me të drejtat etj. Nga akti i ekspertimit mjeko-ligjor, rezulton që shkaku i vdekjes së 27-vjeçarit ka qenë, ndalimi i menjëhershëm i punës së zemrës, me mekanizmin e shemisë akute të miokardit, sëmundje kronike të mushkërive dhe prezencë të produkteve narkotike. Nga hetimi i Avokatit të Popullit rezulton se në ambientin e dhomave të sigurisë të Ko-



27-vjeçari Enea Ftoi

misariatit të Korçës, sistemi për kontrollin, monitorimin dhe regjistrimin me anë të pajisjeve audio vizive, të veprimeve të punonjësve të policisë, që kryejnë me të arretuarit/ndaluarit, marrjen në pyetje nga përfaqësuesit e organit të akuzës, nuk funksionojnë prej disa muajsh. Gjithashtu, në dhomën e marrjes në pyetje të të arretuarve/ndaluarve, nuk janë instaluar kamera, edhe

pse kjo parashikohet në ligje dhe rregulloret përkatëse. Megjithatë ligji parashikon që kontrolli mjekësor i të arrestuarve/ndaluarve kryhet nga mjeku apo ndihmësmjeku i Komisarariatit, në Komisarariatin e Korçës, këtë detyrë e kryente një infermier, që sipas vlerësimit të Avokatit të Popullit, nuk ka aftësinë profesionale të konstatimit apo trajtimit të problemeve shëndetësore të të

NGJARJA


Enea Ftoi ndërroi jetë më 17 maj të këtij viti në ambientet e paraburgimit të Korçës, ku kishte tri ditë që qëndronte pasi ishte ndaluar për vjedhje me dhunë. Ftoi, ditën kur ndodhi ngjarja, duhej të dilte në sallën e gjyqit për akuzën që rëndonte ndaj tij. Ndonëse familjarët e prisnin atë në sallën e gjyqit, ata u njoftuan për ngjarjen e rëndë. Fill pas ngjarjes, familjarët e viktimës hodhën akuzë të rënda, për policinë, pasi kanë dyshime se djali i tyre është dhunuar në paraburgim, që i ka shkaktuar edhe vdekjen.

ndaluarve", thuhet në njoftimin zyrtar të Avokatit të Popullit. Ndërkaq, Avokati i Popullit, referuar rastit të Enea Ftoi i ka rekomanduar Drejtorisë së Policisë së Korçës, instalimin e sistemit të monitorimit në dhomat e sigurimit dhe në ambientet e tjera të Komisarariatit ku kryhet marrja në pyetje të të ndaluarve. Si dhe plotësimin e organikës së drejtorisë me mjek me kohë të plotë pune.

I riu vdes në spital, familjarët akuzojnë mjekes për mjekim të pakujdesshëm

BERAT - Një 31-vjeçar ka vdekur në spitalin rajonal të Beratit në rrethana ende të paqarta. Mësohet se Marinell Veleshnja ka ndërruar jetë 30 minuta pasi ka mbërritur në repartin e urgjencës së këtij spitali. Ngjarja ka ndodhur dy ditë më arë, ndërsa familjarët e të riut kanë denoncuar për "mjekim të pakujdesshëm" mjekun e këtij reparti, Arjola Xheblati,

për të cilën tashmë ka nisur procedimi penal. Burime nga Drejtoria e Policisë Vendore të Beratit bënë dije me dije se menjëherë pas denoncimit të bërë nga familjarët, efektivët kanë sekuestruar si provë materiale kartelën mjekësore të 31-vjeçarit dhe autopsy që u krye në morgun e spitalit. Ndërsa, çështja në fjalë i është referuar prokurorisë së rrethit të Beratit. Nga kjo e fundit konfirmohet se dosja në ngarkim të mjekes ka mbërritur në këtë institucion dhe do fillojnë hetimet për zbardhjen e kësaj ngjarjeje. Mjekja e repartit të Urgjencës, 29-vjeçarja Arjola Xheblati akuzohet për veprën penale "Mjekim i pakujdesshëm" gjatë kryerjes së ushtrimit të profesionit të saj. Në lidhje me këtë vdekje, drejtuuesit e Spitalit Rajonal Berat konfirmojnë se viktimja ka mbërritur në spital në gjendje të rëndë dhe pa shenja jetike.



Dyshimi, policia: Ngjarja ka marr shkas për hasmëri

Qëllohet me breshëri plumbash, plagoset në atentat 50-vjeçari Elez Bodisha

TIRANË - Një 50-vjeçar nga Kamza ka mbetur mbrohë me plagosur në një atentat, ndërsa dyshohet se ngjarja ka marrë shkas për hasmëri. Burime nga policia bëjnë me dije se ngjarja ka ndodhur rreth orës 20:07 në Valias. Mësohet se i plagosuri është shtetasi Elez Bodisha, i cili është dërguar urgjentisht në spital dhe fatmirësisht ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Sipas të dhënave paraprake, mësohet se persona të paidentifikuar kanë qëlluar me breshëri drejt banesës së Bodishës ku ka dhe një ambient të përshtatur si bar, duke zbratur rreth 20 plumba. Menjëherë uniformat blu kanë shkuar në vendin e ngjarjes dhe kanë nisur hetimet për identifikimin dhe vënien në pranga të autorit/ve të krimit. Sipas burimeve të mësipërme, policia ka ng-



ritur pika kontrolli në akset rrugore dhe hyrje-daljet e kryeqytetit. Ngjarja dyshohet për shkakë hasmërie, pasi i vëllai i 50-vjeçarit Bodisha ka vvarë dy persona në aksin Kalimash-Kukës kohë më parë.

"Më datë 25.10.2018, rreth orës 20:07, në Valias të Kamzës është plagosur me armë zjarri në rrethana ende të pa qarta shtetasi E.B., 50 vjeç. Shtetasi i dëmtuar aktualisht ndodhet në spital

“

HASMËRIA

Pas plagosjes së 50-vjeçarit, Elez Bodisha, policia ka ngritur pika kontrolli në akset rrugore dhe hyrje-daljet e kryeqytetit. Ngjarja dyshohet për shkakë hasmërie, pasi i vëllai i 50-vjeçarit ka vvarë dy persona në aksin Kalimash-Kukës kohë më parë.

jashtë rrezikut për jetën. Po bëhet krehja e zonës, terroristët përret, si dhe janë ngritur pika kontrolli në akset rrugore dhe hyrje-daljet e kryeqytetit", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.

Arrestohet 'Pasari shqiptar' në Greqi, përdorte 7 emra dhe 10 mbiemra

GREQI - Policia greke ka arrestuar një shqiptar, i cili konsideruar tepër i rrezikshëm. 44-vjeçari nga Saranda, konsiderohet në vendin fqinj si "Pasari shqiptar", referuar kriminelitet të rrezikshëm grek Kostandinos Pasaris, i cili vrau disa policë në Greqi dhe u kap në Rumani. Shqiptari është kapur në lagjen "Kalithea" të Athinës, bashkë me një tjetër shqiptar 29-vjeçar, por identiteti i tyre nuk bëhet i ditur. Sarandjoti është kapur me një pistoletë, ndërsa ndaj tjetrit kish-te urdhër arresti për vjedhje. Për policinë greke, sarandjoti 44-vjeçar njihje me pseudonimin "Merkuri" dhe përdorte 7 emra, 6 atësi dhe 10 mbiemra. Identiteti i tij i vërtetë u vërtetua në vitin 2008 pas bashkëpunimit me policinë shqiptare. Ai u arrestua në Greqi në vitin 2008 për një serë grabitjesh, kundërshtim me armë të policisë, por dhe për një vrasje të ndodhur në Greqi si shenjë hakmarrjeje për një tjetër vrasje të ndodhur në Sarandë në fillim të viteve '90. Ai kishte pak kohë që kishte dalë nga burgu, pas kryerjes së dënimit.



STRATI Shoqëria përbarimorë "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shqiptarët për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

"Dyçmë", me sipërfaqe 60 m², ndodhur në Rruga e Durrësit, Tiranë, Zona Kadastrale 8310, regjistruar në Regjistrin Hipotekor me nr. 518, datë 13.03.2007, në pronësi të Shoqërisë "LIM-EM" sh.p.k, i cili si garanci hipotekore për Bankën Tiranë sh.a me Kontratë Hipotekë Nr. 1201 Rep., Nr. 800/3 Kol., datë 13.03.2008. Çmimi fillestar i ankandit është 48,082 Euro.

- Ankandit për pasurinë e mësipërme zhvillohet në datë 21.10.2018.

Ankandit për pasurinë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përbarimorë "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

ZYRA PERBARIMIT GJYQESOR KORÇE

1-Me date 01.11.2018, ditën e Enjte ora 16.00 perfundon ankand i pare per pasurine: (Apartament) me nr.pasurie 4/267+1-2,zk.8662,vol.1,fq.227 me sipërfaqe prej 52 m² regjistruar ne Z.V.R.P.P. Korçe, e ndodhur ne adresen Lagjia nr.4, Rr. "Todi Vogli"pallati nr.4,Shk.a,K.4,Korçe

2-Cmimi fillestar me te cilin fillon ankandit eshte 1.360.000_Leke.

Ankandit zhvillohet ne ambientet e Zyres se Perbarimit Korçe Me adrese Bulevard "Republika" Keshilli Qarkut,Kati 4, Korçe tel.082245621

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
Zyra përbarimorë "Best 2010"

SHPALLJE ANKANDI

Me datë 26 nëntor 2018 nga ora.08.00-ora.16.00 tek kjo zyre përbarimorë do zhvillohet seanca e fundit e mbledhjes së ofertave për ankandin e III-të, për shitjen e a) nr.pasurie 26/106+1-26, vol 52, fq.1, ZK.8603, sip. 105 m² me çmim fillestar 2976750 lek; b) nr.pasurie 26/187-ND, vol 52, fq.28, sip.513.4 m² me çmim fillestar 22640940 lek.

Të dyja prona ndodhen në të njëjtin pallat (i ndodhur përballë Teatrit "Petro Marku", Vlorë) që ka ndërruar Debitori "CO.BE.IN" shpk (NUIIS J97201218L). Për sqarime të mëtejshme kontaktoni në tel: 052226000 ose cel: 0692075 644

Motra, oficerëve: Vëllai ndodhet jashtë vendit

Nuk gjendet Lul Berisha, shtyhet për herë të tretë seanca për atentatorin Ahmet Ajeti

TIRANË - Gjykata e Krimeve të Rënda ka vendosur sërish shtyrjen e seancës gjyqësore për Ahmet Ajetin, organizatorin e një atentati ndaj Lulzim Berishës. Kjo është hera e tretë që dështon seanca ndaj Ajetit. Mësohet se gjyqi është shtyrë, pasi policia nuk ka mundur të gjejë dhe të njoftojë të dëmtuarin Lulzim Berisha. Në seancën e djeshme, gjykatësi Bib Ndreca ka sqaruar se policia e Durrësit nuk e ka gjetur në banesën e tij. Për këtë është takuar edhe e motra e tij, e cila i ka thënë oficerëve se i vëllai ndodhet jashtë vendit. Nga ana tjetër, referuar të dhënave të sistemit TIMS, gjykata tha se Lul Berisha rezultoi të jetë brenda vendit. Në këto kushte, seanca është shtyrë



Lulzim Berisha

për në datën 5 nëntor. Ahmet Ajeti akuzohet se në vitin 2005 ka bërë një atentat për vrasjen e Lulzim Berishës. Ai është dënuar në mungesë me 20 vjet burg për tentativë

vrasjeje, ndërsa u ekstradua nga Lipjani i Kosovës, në Shqipëri 4 muaj më parë. Pas ekstradimit, Ajeti kërkoi rihapjen e çështjes dhe rishqyrtimin e dosjes në pra-

ni të tij. Ngjarja për të cilën është dënuar ka ndodhur më 30 gusht të 2005-ës. Ahmet Ajeti dhe O.K., të porositur nga shtetasit E.D., dhe A.C., kanë shkuar nga Tirana në Durrës për të vrarë Lul Berishën. Para se të kryhej atentati në afërsi të lokalit ku ndodhej Berisha, Ajeti është konfliktuar me disa persona të panjohur dhe në grindje e sipër ka nxjerrë pistoletën ku dhe është vetëplagosur. Ajeti ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Tirana më 07.03.2016, pasi Gjykata e Shkallës së



Atentatori Ahmet Ajeti në sallën e gjyqit

Parë për Krimet e Rënda, Tiranë, me vendimin nr. 01 datë 16.01.2012, e ka dënuar me 20 vjet burg për veprën penale "Vrasje me paramendim" dhe "Armëmbajtje pa leje". Si rezultat i bashkëpunimit të Interpol Tirana me Policinë e Kosovës, u bë i mundur arrestimi i tij në Kosovë, duke

u finalizuar me ekstradimin e tij drejt vendit tonë. Ajeti nuk është një emër i panjohur për drejtësinë shqiptare, pasi ai ka qenë pjesë e bandës së Endrit Dokles e Adriatik Colit. Pretendohet se është paguar me 80 mijë euro në vitin 2005 për të vrarë Lulzim Berishën.

Operacioni "Ndëshkimi i të fortëve", policia: Në pak javë kemi prangosur mbi 300 persona

I dënuar me 16 vite burg për pedofili, arrestohet në Tiranë italian 45-vjeçar

Në periudhën 2007-2014, Masimilliano Croce ka abuzuar me fëmijët e varfër e jetimë në periferi të Romës

TIRANË

Policia e Shtetit në bashkëpunim me autoritetet italiane kanë arrestuar një shtetas italian, pasi ishte dënuar në mungesë nga drejtësia e vendit fqinj për krim ndaj të miturve. Bëhet fjalë për 45-vjeçarin Masimilliano Croce, i dënuar me 16 vite burg nga Gjykata e Romës, pasi kur ka shërbyer si mësues komuniteti për fëmijët e varfër dhe jetimë, në provincat e Romës, ka abuzuar seksualisht me ta. Ai është prangosur në Tiranë, falë shkëmbimit të informacioneve midis policive të dy vendeve. Mësohet se 45-vjeçari italian kishte marrë me qira një banesë dhe fshihej aty për t'i shpëtuar arrestimit. Hetimi ndaj tij ka nisur në mesin e muajit tetor të këtij viti. Detajet e operacionit për kapjen e të kërkuarit u bënë të ditura ditën e djeshme gjatë një konference të përbashkët për shtyp nga drejtori i Departamentit të Policisë Kriminale, Edi Merkaç dhe Vincenzo Calabrese - përfaqësues i Drejtorisë Qendrore Kriminale në policinë italiane.

ARRESTIMI

"Operacioni u krye në bashkëpunim të ngushtë me Policinë së Shtetit me Shërbimin Qendror Operativ në Drejtorinë e Përgjithshme Antikrim, skuadra e lëvizshme e kuesturës së



45-vjeçari i arrestuar Masimilliano Croce

Romës dhe Zyra e Interforcës pranë ambasadës italiane në Shqipëri. Hetimi ka nisur në mes të muajit tetor dhe u mbyll me sukses në më pak se 15 ditë, falë bashkëpunimit intensiv ndërmjet agjencive tona dhe atyre

italiane. Shtetasi i arrestuar quhet Masimilliano Croce, 45 vjeç, nga Ciampino, Romë, i diplomuar për pedagogji për të mitur", bëri me dije policia. Ndërkaq, gjatë konferencës u deklarua se ky shtetas, në peri-

udhën 2007-2014 ka kryer krime kundër të miturve, abuzime me fëmijë, pedofili. Në vitin 2017 është dënuar nga kjo gjykatë me vendim të formës së prerë, me 16 vite burg, për veprën penale: "Dhunë seksuale ndaj të miturve". Ky shtetas, gjatë periudhës së kryerjes së këtyre krimeve, ka shërbyer si mësues komuniteti për fëmijët e varfër dhe jetimë, në provincat e Romës dhe në qytetin e Romës. "Pas shkëmbimit të informacionit në kohë reale midis kolegëve italianë dhe Drejtorisë Hetimore Qendrore pranë Departamentit të Policisë Kriminale është bërë i mundur lokalizimi dhe arrestimi i autorit, i cili fshihej në një banesë me qira në një zonë periferike të Tiranës. Autori i arrestuar i fshihej drejtësisë italiane prej më shumë se 4 vitesh. Operacioni i kryer është

BASHKËPUNIMI

Që prej mesit të muajit shtetit është e angazhuar në një operacion të gjerë për kontrollin e territorit, të koduar "Ndëshkimi i të fortëve". Sipas burimeve zyrtare, mbi 300 persona me precedentë dhe të skeduar janë arrestuar për disa javë në këtë kuadër, mes tyre mbi 160 vetë në kërkim kombëtar e ndërkombëtar.

Tentuan të trafikonin 80 kg kanabis në Mal të Zi, lihen

në burg 6 të arrestuarit

SHKODËR - Gjykata e Shkodrës ka vendosur masën e sigurisë "Arrest me burg" për 6-të personat, të cilët u arrestuan në Tamarë të Malësisë së Madhe. Në aksionin e koduar "TAMARA" pak ditë më parë, policia sekuestroi 80 kg kanabis, ndërsa vuri në pranga shtetasit: Kristjan Bujaj, Gjeto Pepaj, Pellumb Murçaq, Lazër Murçaq, Lavdrim Nikaj dhe Ndue Nilaj. Gjatë seancës për masën e sigurisë, të dyshuarit që nuk kanë pranuar akuzat e ngritura për ta nga policia dhe prokuroria. Ata u shprehën se nuk kanë lidhje me njëri-tjetrin sa u përket akuzave të ngritura si një grup kriminal që merrej me transportimin e drogës. Avokatët mbrojtës në sallën e gjyqit kërkuan masë lehtësuese për klientët e tyre, por gjykata në fund ka pranuar kërkesën e prokurorisë duke vendosur lënie e tyre në qeli. Sipas prokurorisë, këta persona janë një grup kriminal që po tentonin të transportonin një sasi droge prej 80 kg nga Shqipëria drejt Malit të Zi përmes një pike kufitare në afërsi të Tamarës në Malësi të Madhe. Gjithashtu, personat e mësipërm dyshohet se bashkëpunim me njëri-tjetrin për transportimin e drogës drejt shtetit fqinj.

NJOFTIM

Shoqëria "GPP Korça" sh.p.k., propozon ndërtimin dhe operimin e një termocentrali me gaz me cikël të kombinuar kogjenerimi CCCPP KORCA 500 MW/ 80 MW/ 6 MW në zonën pranë qytetit të Korçës, saktësisht përballë Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Qytetit të Korçës. GPP Korça ka kontraktuar kompaninë ABKONS sh.p.k. për realizimin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, si shoqëri e lincensuar për veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis.

Për këtë qëllim, Ju njoftojmë se në Korçë do të mbahet një Dëgjese Publike për të bërë publike rezultatet e vlerësimit mjedisor dhe për të diskutuar dhe mbledhur komentet dhe sugjerimet nga pjesëmarrësit.

Dëgjesa Publike do të mbahet në datën **26 Tetor 2018** në orën **12:00** ne sallën e takimeve tek **"Grand Hotel Korça"**

Projekt 50 milionë dollarë për rrugën Pogradec-Tushemisht

Fshati i famshëm i Teto Ollgës e Thethi i bukur i lartësive të mëdha do të jenë së shpejti lehtësisht të arritshme sa i takon infrastrukturës. Bashkë me to edhe rruga Fier-Seman, mund të quhen investime që më shumë sesa vetëm rrugë rajonale apo lokale përbëjnë një mundësi të re për zhvillimin e turizmit dhe bujqësisë në këto zona. Të paktën ky është qëllimi i programit "Rrugët lidhëse rajonale dhe lokale" që u prezantua pak ditë më parë në mjediset e Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Ky projekt financohet nga qeveria shqiptare

nëpërmjet një kredie prej 50 milionë dollarë nga Banka Botërore. Projekti është finalizimi me sukses i një pune të nisur më shumë se një vit e gjysmë më parë nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

"Ka qenë një nismë e qeverisë për të financuar në rrejtin rrugor dytësor të vendit veçanërisht në zonat me potencial më të rëndësishëm turistik e bujqësor", ka thënë Benet Beci, Drejtori Ekzekutiv i FSHZH ditën e prezantimit të projektit. Sfidat e re të FSHZH është ndërtimi sipas parametereve i infrastrukturës që çon në destinacione me potenciale të larta të zhvillimit të turizmit, agribi-



znesit dhe bujqësisë. Konkretisht rruga Pogradec-Tushemisht, pjesë e projektit të prezantuar, kontribuon gjithashtu edhe në një lidhje më të mirë ndërkufitare me Maqedoninë, por edhe ndikon në largimin e trafikut nga Bregu i Liqenit.

Përcillet për në banesën e fundit kirurgu i njohur Flamur Tartari

Ditën e djeshme, është përcjellë për në banesën e fundit, Flamur Tartari, një nga kirurgët më të njohur në vend. I konsideruar si "bisturia e artë", Tartari i kushtoi me devotshmëri e dashuri plot 52 vjet mjekësisë shqiptare. Kirurgu i njohur u nda nga jeta në moshën 75-vjeçare duke lënë pas kontributin e tij jo vetëm në misionin fisnik që realizoi me përkushtim, por, gjithashtu, edhe për një sërë veprash shkencore. Gjithashtu, Flamur Tartari ka punuar edhe si pedagog në Fakultetin e Mjekësisë. Pas përfundimit të studimeve të përgjithshme në Fakultetin e Mjekë-



sisë, doktor Tartari u kërkua të shërbente në Durrës si kirurg. Pas kthimit në Tiranë, Tartari u emërua si pedagog në Fakultetin e Mjekësisë. Në vitin 1980, ai mbrojtë me sukses doktoraturën me punime konkrete për hipospadinë. Pas studimeve dhe shërbimit si kirurg në Tiranë, prof. Tartari zhvendoset

në Paris, aty ku u specializua në drejtim të Urologjisë së fëmijëve të vegjël. Me rikthimin në Tiranë, doktori themeloi Urologjinë Moderne Shqiptare të fëmijëve. Pas viteve '90, mjekëve iu dha mundësia të specializoheshin dhe të merrnin pjesë në shumë konferenca si brenda, por edhe jashtë shtetit duke shkëmbyer e përftuar përvoja të shumta për problemet kirurgjikale urologjike. Tartari, një ndërta, kreu specializime të tjera, në Hungari, Holandë, Zvicër, Itali. Janë të panumërta konferencat ku ai ka marrë pjesë. Ai është, gjithashtu, autor i mbi 150 punimeve mjekësore, shkencore dhe publicistike.

"Kujdes nga mashtrimet dhe adresat false në internet. Kriteret që duhet të plotësoni"

Voltiza Duro

Lotaria Amerikane, ambasada: Plotësojeni vetë formularin e aplikimit

"Nuk keni nevojë të paguani dikë për regjistrim"

Të gjithë ata që dëshirojnë të jetojnë e punojnë në tokën e premtuar kanë mundësinë të aplikojë për Lotarinë Amerikane deri në 6 nëntor. Ditën e djeshme, ambasada amerikane në Tiranë, i ka bërë thirrje të interesuarve që të plotësojnë vetë aplikimin e të mos paguajnë para nëpër qendra që ofrojnë këtë shërbim. "Ju nuk keni nevojë të paguani dikë që t'ju kryejë regjistrimin për lotarinë. Ju jeni ekspert i vetes tuaj këtë vit! Plotësojeni vetë aplikimin për lotarinë, është i thjeshtë.", thekson ambasada në njoftimin e saj zyrtar.

MASHTRIMET

"Nëse ju keni marrë një postë elektronike (e-mail) që ju njofton se aplikimi juaj për programin e Lotarisë Amerikane ishte fitues dhe në mënyrë që të vazhdoni me aplikimin tuaj ju duhet të dërgoni një shumë të hollash (para) në emër të një personi, ju jeni viktimë e një



mashtrimi. Vitet e shkuara, aplikantët fitues njoftoheshin nga Departamenti i Shtetit, Qendra Konsullore në Kentucky (QKK) me anë të postës, JO me e-mail dhe të përzgjedhurve u jepeshin udhëzimet se si të vazhdonin në hapat e mëtejshëm të procesit. QKK-ja nuk ju kërkoi juve t'u dërgoni para (të holla) atyre, apo ndonjë ambasade tjetër të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SH.B.A.) me postë apo nëpërmjet shërbimeve si Eastern Union", bën me dije ambasada. Vetëm aplikantët e përzgjedhur njoftohen nga Departamenti i Shtetit, Qendra Konsullore në Kentucky (QKK). Asnjë organizatë tjetër apo kompani private nuk është e autorizuar nga Departamenti i Shtetit për të njoftuar aplikantët e DV-së për përzgjedhjen e aplikimit të tyre si fitues, apo të hapave të mëtejshëm në procesimin e aplikimit për vizë. "SHA adresa interneti mund të tentojnë t'ju çorientojnë duke ju bërë të mendoni që ato janë adresat zyrtare të internetit për Lotarinë e Vizave të Shumëllojshmërisë. Ato mund të tentojnë t'ju kërkojnë të paguani për shërbime si formulari dhe informacionet, të cilat janë falas në adresat e internetit të Departamentit të Shtetit dhe të Ambasadeve. Disa shoqëri kërkojnë pagesa për të plotësuar formularin e aplikimit për Lotarinë e Vizave të Shumëllojshmërisë", bën me dije ambasada.

Shqiptarët braktisin vendin, 560 mijë leje qëndrimi në BE

Plot 560 mijë shqiptarë janë pajisur për herë të parë me leje qëndrimi në vendet e BE-së, këto 10 vitet e fundit. Shifrat zbardhen nga raporti më i fundit i Eurostat, të përpunuara nga Monitor'. Kështu numri i shqiptarëve të pajisur me leje qëndrimi në shtetet e Bashkimit Europian, është sa 19.5% e popullsisë aktuale të Shqipërisë. Në raport më tej theksohet se pjesa më e madhe e lejeve të qëndrimit është lëshuar për arsye familjare. Shqipëria ka shënuar rekord për numrin e lejeve të qëndrimit në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit, ku prej 2008-s qytetarët shqiptarë kanë kryesuar për numrin e tyre. Rekordin e lejeve të qëndrimit të lëshuara për herë të parë këto 10 vjet u shënuan në 2008-mn ku sipas Eurostat u pajisën me leje qëndrimi gati 100 mijë shqiptarë. Më pas numri i lejeve pati rënie, ku në 2013 kapi nivelin më të ulët prej 31 mijë aplikimesh, por duke mbajtur rekordin në krahasim me vendet e Ballkanit Perëndimor. Pas 2013-s numri i lejeve të qëndrimit u rrit sërish. Nga 2014 deri 2017-n u pajisën me leje qëndrimi për herë të parë rreth 200 mijë shqiptarë. Kjo përkon me valën e re të emigracionit, ku aplikimet për azil në 2015-n arritën mbi 60 mijë. Në vitin 2017, numri i lejeve të qëndrimit të lëshuara për shqiptarët nga vendet e BE-së ishte 51 mijë e 600, ku rreth 29 mijë u dhanë për arsye familjare, rreth 2000 për arsye shkollimi dhe 5 mijë për punë. Pas Shqipërisë, për 2017-n me numrin më të lartë lejeve qëndrimi të lëshuara renditet Serbia, ku rreth 40 mijë qytetarë të saj u pajisën për herë të parë me leje qëndrimi nga vendet e BE-së. Në ndryshim nga qytetarët shqiptarë pjesa më e madhe e serbëve kanë marrë lejet e qëndrimit për arsye punësimi, rreth 17 mijë, 13 mijë për arsye familjare dhe 2400 për arsye shkollimi.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje disa pajisje informatike për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 26,542,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraparkisht pagesën e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje disa pajisje informatike për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 21 Nëntor 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Eksperti i ekonomisë: Monopolizimi nga shteti i kësaj veprimtarie është qesharak

Mateo Spaho: Pasojat e rrezikshme që sjell mbyllja e lojërave të fatit

"Çdo vendim ekstrem, sjell rezultate ekstreme"



Voltiza Duro

Ditën e djeshme, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë së lojërave të fatit pas 31 dhjetorit të këtij viti. Në një intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare", Mateo Spaho, ekspert ekonomie dhe njëkohësisht dekan i Fakultetit Ekonomik pranë Universitetit "Luigj Urezi" thekson se mbyllja e pikave të basteve brenda një periudhe 2 mujore, mund të ketë pasoja të rrezikshme. Sipas tij, ndalimi i lojërave të fatit, do të sjellë vështirësi në konvertimin e bizneseve për rreth 9 mijë biznese që ushtrojnë këtë aktivitet në Shqipëri. Por Spaho thekson, gjithashtu, se lojërat e fatit ndikojnë negativisht në të ardhmen e ekonomisë tonë, sepse pengojnë diversifikimin e aktiviteteve ekonomike, dekurajojnë shkollimin e të rinjve, rrisin gjasat për konflikte në familje, si dhe krijojnë iluzione të rreme pasurimi. Eksperti i ekonomisë e vlerëson si qesharak, mundësinë për ta bërë monopol shtetëror këtë biznes.



Mateo Spaho, ekspert ekonomie

RITJIA E PAPANESISE

Natyrish në 1-2 vitet e para do të ketë një rritje të papunesisë dhe një mbyllje të një pjese të bizneseve që veprojnë në këtë fushë për këtë arsye nevojitet një afat kohor më të gjatë se dy muaj për mbylljen e lojërave të fatit dhe një planifikim të zonave ku lojërat mund të lejoheshin. Problemet që Shqipëria ka janë shumë më të thella se lojërat e fatit, por çështja është se duhet që qeveria të krijojë një mjedis pozitiv për të bërë biznes në fushat e tjera.

kurtër që individët të mendojnë në mënyrë serioze për konvertimin e aktiviteteve të tyre.

NUMRI I PIKAVE TË BASTEVE GJATË 5 VITEVE TË FUNDIT ËSHTË KATËRFISHUAR. SI KA NDIKUAR KJO NË EKONOMINË SHQIPTARE?

Në ekonominë shqiptare realisht ka pasur në 5 vitet e fundit një 4-fishim të pikave të bastit. Kjo vjen si pasojë e varfërimit të alternativave për investim që sipërmarësit kanë. Kur them fjalën sipërmarrës nënkuptoj në shumicën e rasteve individë që kanë mundësi për të investuar një shumë nga 10-30 mijë euro. Përtej lokaleve dhe pikave të bastit për meshkujt dhe parukeritë për femrat nuk ka aktivitet të tjera shërbimi të suksesshme. Katërfishimi i pikave të bastit tregon se familjet shqiptare nuk mund të gjejnë në realitetin tonë një mundësi për të punuar ndershmërisht dhe për të pasur sukses në jetën e tyre dhe si pasojë krijojnë iluzione për pasurime të shpejta të bekuara nga fati. Natyrish iluzionet ngelen iluzione ndërsa realiteti tregon se të ardhurat dhe likuiditeti përgjithësisht të gjithnjë e më pak duar. Varfëria e ideve për të bërë biznes dhe mundësia e dobët për të krijuar konsum nga ana e familjeve e ka lënë peng vendin tonë të basteve dhe qoftëve. Nuk ka asgjë të keqe, por të kesh në Shqipëri 44 librari

dhe 4000 pika basti tregon se shqiptarët besojnë se dija dhe kultura janë në realitetin e tyre gjithnjë e më pak të duhura ndërsa para, pavarësisht se si fitohet është gjithçka. Fatkeqësisht nuk mund t'i qortojmë njerëzit pasi ata thjesht vërejnë se në realitetin shqiptar kultura merret për dobësi dhe të fortët komandojnë vendin. Alternativa që ju ngelet njerëzve është të provojnë që të bëhen edhe vetë të fortë.

A mendoni se lojërat e fatit ndikojnë negativisht në ekonomi?

Lojërat e fatit ndikojnë negativisht në të ardhmen e ekonomisë tonë, sepse pengojnë diversifikimin e aktiviteteve ekonomike, dekurajojnë shkollimin e të rinjve, rrisin gjasat për konflikte në familje, krijojnë iluzione të rreme pasurimi, shpërdorojnë kohën cilësore duke ia hequr kulturës, artit, sportit, argëtimit, raporteve miqësore dhe personale. Por çdo vendim ekstrem rrezikon të sjellë rezultate ekstreme. Dua të them se një mbyllje e shpejtë dhe totale rrezikon krijimin e qendrave klandestine të jash-tëligjshme të basteve dhe të lojërave të fatit, ku do të sundonte dhuna dhe krimi duke rritur pasigurinë në qytetet tona. Rreziku është edhe më i lartë nëse mendojmë se sa jo eficientë është Policia e Shtetit dhe se penetruar nga elementet kriminale është

MONOPOLIZIMI

Mundësia për ta bërë monopol shtetëror këtë biznes është sikur të thuash që shteti duhet të bëjë monopol prodhimin e bukës ose të ketë vetëm shkolla shtetërore...Ky qëndrim është tipikisht monist. Besoni se kush është i varur nga lojërat e fatit nuk do të lozë më kur do të mësojë se pronari është shteti???? Qesharake...

rregulla që të gjithë duhet t'i zbatojnë (duke filluar nga vetë shteti, i cili në Shqipëri shpesh-herë i shkel vetë). Por aktiviteti ekonomik është i vitalizuar nga privatët. Si thoni ishte më mirë para viteve 90' kur kishte vetëm një lloj buke apo sot ku konsumatori ka të drejtë të zgjedhë ngjyrën, përberjen dhe formën dhe gminin e bukës midis shumë alternativave...

Tashmë që mijëra pika bastesh do të mbyllen, a do të rritet edhe papunesia?

Natyrish në 1-2 vitet e para do të ketë një rritje të papunesisë dhe një mbyllje të një pjese të bizneseve që veprojnë në këtë fushë për këtë arsye nevojitet një afat kohor më të gjatë se dy muaj për mbylljen e lojërave të fatit dhe një planifikim të zonave ku lojërat mund të lejoheshin. Problemet që Shqipëria ka janë shumë më të thella se lojërat e fatit, por çështja është se duhet që qeveria të krijojë një mjedis pozitiv për të bërë biznes në fushat e tjera. Deri tani kemi parë tatimorë, inspektorate, taksa të reja, rritje çmimesh për karburantet dhe energjinë elektrike. Ndërkohë që shumica e shqiptarëve që duan të hapin një biznes e gjejnë tregun të kapur nga miqtë e pushtetit dhe nuk iu ngelet një gjë tjetër veçse të hapin një qoftë, parukeri apo një bast. Tani do të kenë një mundësi më pak dhe një pengesë më shumë. Bastet ishin strofulla e iluzioneve të shqiptarëve, për të marrur një realitet pa alternativë.

dhimin e Brendshëm Bruto.

Deri më tani po konsiderohet mundësia e trajtimit të kësaj veprimtarie si monopol shtetëror. A do të jenë më të kontrolluara këto pika në këtë mënyrë?

Mundësia për ta bërë monopol shtetëror këtë biznes është sikur të thuash që shteti duhet të bëjë monopol prodhimin e bukës ose të ketë vetëm shkolla shtetërore...Ky qëndrim është tipikisht monist. Besoni se kush është i varur nga lojërat e fatit nuk do të lozë më kur do të mësojë se pronari është shteti???? Qesharake... Në të gjitha vendet me ekonomi tregu të zhvilluar dhe me shtet të së drejtës shteti është rregullator jo aktor, gjë që do të thotë se shteti duhet të vendosi



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR SHOQUARUR ME FTESA DIREKTE KANDIDATEVE TE HUAJ

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Automatizimi i sistemit përpilues dhe raportues të statistikave të sektorit jashtëm, për nevojat e Bankes së Shqipërisë"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar shoqëruar me ftesa direkte kandidateve të huaj", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 37,100,000 Lekë ose 296,000 Euro".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10:00 - 13:00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të kenë bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në logarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Automatizimi i sistemit përpilues dhe raportues të statistikave të sektorit jashtëm, për nevojat e Bankes së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 27 Nentor 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Momentet përtej dritave të spektaklit dhe puna me vajzat e bukura të mbarë botës

Petri Bozo:

Ja çfarë nuk dini për fituesen kineze të "Miss Globe 2018"

"Nëse nuk do të bija dakord me Aldën, nuk do kishim kaq sukses"

Egla Xhemali

Kompeticioni i së bukurës, "Miss Globe 2018", u fitua për herë të parë nga një vajzë kineze, e cila shkëlqeu përgjatë sfilatave me veshjet e shumëgjyreshë e me stil të jashtëzakonshëm. Petri Bozo ndan me ne të fshehtat e këtij spektakli, që pati mjaft risi këtë vit. Producenti dhe detaje mbi të bukurën që ishte impresionante në sjellje dhe pas marrjes së çmimit. Bozo na tregon se produktiviteti i kompeticioneve të bukurisë varet nga vendi ku ato zhvillohen. Ai thotë se ka mësuar shumë nga spektakli me përmasa ndërkombëtare dhe se pavarësisht të gjithave, bie dakord kurdoherë me bashkëshortin e tij, Aldën, që është njëkohësisht edhe bashkëpunëtorja e tij. Për të ky është çelësi i suksesit këto vite. Më tej, producenti rrefen se çfarë e intrigon përpos spektakleve me miset.

Çfarë nuk kemi arritur të zbulojmë për fituesen e "Miss Globe 2018"?

Sa i përket fitueses të "Miss globe 2018", kinezes Yu Yizhou, për herë të parë kemi pasur një vajzë kineze, e cila komunikonte në anglisht shumë e përgatitur për gjatë gjithë vitit në Kinë për pjesëmarrjen në "Miss Globe 2018", duke i dhënë shumë rëndësi raportit të veshjes, por edhe raportit të komunikimit. Është një vajzë që studionte për shkencë komunikimi dhe marketing në një nga universitetet më prestigjioze të Shangait në Kinë. E blinduar me një ekip prej gjashtë vetash, që e shoqëronin me një shumëllojshmëri të veshjeve, me shumë se çdo konkurrencte tjetër. Ishte sigurisht impresionante e gjithë sjellja e saj deri në marrjen e titullit dhe për herë të parë në 15 vjet që ne bëjmë eventin e "Miss Globe" nga viti 2004, nga amfiteatri i Durrësit tek liqeni, asnjë kineze nuk e kishte fituar këtë



kurorë më parë, kështu që është një fakt shumë pozitiv për markën, të cilën e zotërojmë me të drejta të plota të regjistruara në Amerikën e Veriut në Ke Bek dhe zotërimi i kurorës nga një shtetase me një popullatë të jashtëzakonshme është dicka mjaft e mirë për nivelin që meriton kjo markë dhe ky event, i cili renditet nga top-ten eventet e bukurisë në botë.

Sa produktiv janë kompeticionet e bukurisë sot?

Sot kompeticionet e bukurisë është e vështirë ta thash sa produktivë janë, pasi varet nga vendi ku zhvillohen. Janë shumë produktivë në vendet e Azisë, në disa vende të Amerikës Latine dhe pak produktiv në zonën e Evropës, në Afrikë pothuajse aspak, pasi është i pamun-



qenë shumë të kujdesshëm që të mos komunikojmë deri aty sa të bëjmë të pakënaqur një konkurrencte të një shteti.

Cilin detaj të spektakleve në Shqipëri e konsideron jashtë mode?

Asnjë spektakël mendoj unë nuk është jashtë mode, sepse në fund fare sjellin argëtim për një popull jashtëzakonisht të vuajtur siç janë shqiptarët, të mbytur me lajme të tmerrshme arrestime, vdekje, vrasje kështu që për mua bëhet pak në drejtim të investimit në realizimin e spektakleve në Shqipëri. Mendoj që çdonjëri nga institucionet që e ka në dorë pjesën e financës duhet ta marrë në konsideratë këtë fakt.

Për çfarë nuk bini asnjëherë dakord me gruan dhe bashkëpunëtorin tuaj, Alda Bidën?

Sa i përket raportit me Aldën, biem gjithmonë dakord. Sigurisht kemi debatet tona si të gjitha raportet për ta shoshitur çdo gjë në detaj, por në fund fare nëse nuk do binim dakord, nuk do prodhohim dot kaq sukses kaq gjatë. Kështu që në fund të ditës të gjithë biem dakord.

Dicka që ju intrigon, përveç spektakleve me miset?

Ajo që më intrigon përveç spektakleve të misëve, jo se nuk e kam bërë, pasi ne prodhojmë festivalin "Netët e klipit". Prej 15 vitesh është ky kompeticion muzikor. E kemi ndaluar në dyvjetëshin e fundit për shkak të produksioneve të dobëta të klipëve, për sa u përket tematikave që trajtojnë dhe po përpiqemi ta kalojmë një herë në dy vite spektaklin e sigurisht që vitin tjetër do të kemi prapë një mbrëmje të paparë gala netësh klipi nga Ulqini, sepse po përpiqemi të biem në dakordësi me komunën e Ulqinit për ta shndërruar Ulqin si një qytet festivalit "Netët gala të klipit" me një raport afatgjatë siç e përmenda edhe më sipër. Do jetë çdo dy vite kjo komunë e shndërruar si Kana apo si Venecia, që kanë festival që jetojnë prej 50 apo 60 vitesh, ku do



realizohen mbrëmjet gala të netëve të klipit shqiptar. Pse të mos jetë Ulqini, vendi mikpritës i të gjitha produksioneve nga të gjitha trevat e Shqipërisë dhe nga diaspora. Dicka tjetër që më intrigon janë garat sportive. Jam kënaqur jashtë mase me kampionatin botëror të parash-

utizmit me Alketin në Vlorë, që e transmetuam 'live' prej nëntë ditësh nga pesë orë transmetim në ditë. Një produksion i fantastik i RTSH-së dhe kam dëshirë prapë që ta bëj. Këtë vit ata kanë kupën e botës në dimër dhe me siguri do të jem aty, në Korçë për ta bërë.



Era Istrefi foto të nxehta para pasqyrës

Mesa duket ajo nuk do ndalet së postuari fotografi pro vokuese. Era Istrefi vazhdon të jetë mjaft aktive edhe në rrjetet sociale ku po sjell imazhe dhe video nga më të ndryshmet. Së fundi, Era publikoi në llogarinë personale në "Instagram" një fotografi teksa shihet lakuriq në pjesën e lartë të trupit, ndërsa poshtë ka të veshur një palë pantallona ngjyrë rozë. Artisja për momentin nuk gjendet në vendlindje pasi është duke punuar në këngë të reja që pritet të vijë shumë shpejt para publikut.



E kryqëzuan për gungën në pantallona, zbuloni si përgjigjet këngëtarja

Ajo është një nga vajzat më të përvolura të momentit për fotot dhe ekstravagancën në klipet e saj muzikore, megjithëse së fundmi diçka mjaft e çuditshme ka tërhequr vëmendjen e të gjithëve. Në imazhin që Ronela ka postuar në "Instagram", shfaqet e veshur me një palë palçeta ngjyrë jeshile ulliri, që janë të lirshme veçanërisht në pjesën e poshtme. Pjesa e varur dhe qëndrimi i këngëtares gjatë pozimit për foto kanë bërë që në pjesën intime të krijohet një rrudhë në formë gunge, që nuk ka kaluar pa u vënë re.

"Dukesh sikur ke penis", i shkruan një ndjekës, i ndjekur nga shumë të tjerë që bëjnë batuta në lidhje me këtë detaj. Por, megjithatë, një gjë e tillë duket se nuk e ka sikletosur aspak Ronelën, e cila nuk ka ngurruar të replikojë duke thënë se ata që nuk kanë çfarë bëjnë gjithë ditën merren me të.



Kush është gazetarja më seksi sipas mediave franceze?

Ida Bejleri është padyshim një prej vajzave më seksi të showbiz-it dhe jo pak herë provokon me fotot e saj mjaft sensuale. Megjithatë kjo nuk ka kaluar pa u vënë re dhe nga mediat franceze, të cilat kanë shkruar për gazetaren sportive. "Ju prezantojmë me Ilda Bejlerin, një gazetare sportive shumë e njohur në Shqipëri dhe e kuptojmë pse", shkruan "La minute Football" në "Facebook" teksa kanë postuar dhe disa prej fotove më seksi të saj.



Gjithë bota sytë tek ajo! Trejsi publikon mesazhet e fansave

Bukuroshja është vetëm 18-vjeçare dhe fama e saj si "gangsterja e Elbasanit", pas disa sherreve publike tashmë duket se ka thyer çdo barrierë gjeografike. Me mijëra fansa në Shqipëri ndërsa tani duket se gjithë bota i ka drejtuar sytë nga Trejsi Sejdirini. Në disa foto të postuara në "Instastory", Trejsi ka treguar mesazhet komplimentuese që ka marrë nga fansat nga Turqia, Kolumbia, Panamaja, Bolivia, Meksika, Indonezia etj. Sa shumë e duan këtë vajzë! Me siguri Trejsi se shpejti do të jetë një divë e niveleve ndërkombëtare.



Presidenti i Kosovës: Mundësi e mirë për të reflektuar

Dialogu me Serbinë, Thaçi merr ftesë për takimin me Vuçiç

Në fillim të muajit u përfol për një ftesë dhe një dritë jeshile lidhur me dialogun Kosovë-Serbi, mundësi e dhënë kjo nga Presidenti i Francës, Emanuel Makron. Ndërkaq, ftesa zyrtare që presidenti kosovar, Hashim Thaçi ka marrë nga homologu i tij për të qenë pjesë e ceremonive të 100-vjetorit të fundit të Luftës së Parë Botërore është bërë e ditur vetëm dje. Pjesëmarrjen në ceremonitë që do të organizohen më 11 nëntor e konfirmoi pak ditë më parë edhe presidenti serb, Aleksandër Vuçiç. Për më tej, Emanuel Makron synon të jetë organi-

HASHIM THAÇI

"Përtej përkujtimit, kjo është një mundësi për të reflektuar rreth rendit të sotëm botëror dhe përgjegjësisë sonë kolektive për forcimin e paqes botërore dhe qeverisjes, duke pasur parasysh mësimet e nxjerra nga Lufta e Parë Botërore", ka thënë Thaçi.

zator i një takimi mes udhëheqësve të dy vendeve ballkanike, që i ndan një kaluar e gjatë konfliktuale. "Përtej përkujtimit, kjo është një mundësi për të reflektuar rreth rendit të sotëm botëror dhe përgjegjësisë sonë kolektive për forcimin

e paqes botërore dhe qeverisjes, duke pasur parasysh mësimet e nxjerra nga Lufta e Parë Botërore". Takimi synon të fusë në një fazë të re dialogun e Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve dypalëshe, ku temë kryesore këtë herë do

të jetë rishikimi i kujfijve mes Kosovës dhe Serbisë dhe njohja reciproke mes dy vendeve. Presidenti kosovar synon të shtrojë për diskutim edhe bashkëngjitjen e luginës së Presevës me Kosovën, çka refuzohet kategorikisht nga kreu i shtetit serb. Ndërkohë që Thaçi, kohë më parë, bashkë me kryeministrin shqiptar Edi Rama bashkëbiseduan në Samitin e Frankofonisë në Jerevan të Armenisë, ku mendohet se u arrit dakordimi për takimin e 11 nëntorit në kryeqytetin francez. Nga ana tjetër, presidenti ka



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi

përgëzuar Gjykatën Kushtetuese me rastin e shënimit të vitit të 9-të gjyqësor. Në fjalën e tij të rastit, Presidenti Thaçi ka kërkuar që Gjykata Kushtetuese të vazhdojë të ketë rolin e saj të rëndësishëm në mbrojtjen e rendit dhe Kushtetutës në vend. "Gjykata Kushtetuese du-

het të vazhdojë të luajë rol në mbrojtje të Kushtetutës. Duke mbrojtur rendin e Kushtetutës ju mbrojmë themelet e Kosovës dhe shtetin tonë. Barazia para ligjit, mbrojtja e identitetit të qytetarëve janë parimi i drejtësisë sonë", është shprehur Thaçi.

Konferenca në Budva, Kurc: Urime për miratimin e Marrëveshjes së Prespës!

Gjeorgje Ivanov: Historinë tonë do ta shkruajë Greqia

Presidenti maqedonas: Na mohuan të drejtën për vetëvendosje

Ditën e djeshme në konferencën shkencore në Ohër kushtuar 1000-vjetorit pas shtetit të Mbretit Samoil, presidenti i Maqedonisë, Gjeorgje Ivanov nuk harroi të fokusohet në Marrëveshjen e Prespës për çështjen e emrit. Sipas tij, në këtë mënyrë do të shkohet deri të shkrimi i të ashtuquajturës histori e re politikisht korrekte, në të cilën do të vendosen gjëra të shkruara sipas vullnetit të Greqisë, e cila do t'u mësohet fëmijëve nëpër shkolla dhe studentëve nëpër fakultete. "Me Marrëveshjen e Prespës, veprimtarinë tuaj akademike dhe arsimore do ta mbikëqyrin politikanë, diplomatë dhe burokratë të cilët seriozisht do t'i censurojnë librat që ju i shkruani apo prej të cilave ju ligjëroni", - deklaroi Gjeorgje Ivanov. Para pjesëmarrësve në konferencë, Ivanov tha se autorët e tekstit të Marrëveshjes së Prespës kanë treguar mosnjohje të historisë së Ballkanit. "Por, ata shkojnë një hap më larg dhe mohojnë shumë vlera universale. Para së gjithash, e mohojnë të drejtën për vetëvendosje që do të thotë se vetëm kombi ka të drejtë të vendosë për fatin e vet dhe se askush nuk është i autorizuar me dhunë të ndërhyjë në jetën e tij", - tha Gjeorgje Ivanov. Ashtu siç parashikon Marrëveshja e Prespës, tashmë u formua komiteti i përbashkët i ekspertëve të historisë, arkeologjisë dhe gjuhësive arsimore mes Maqedonisë dhe Greqisë. Komiteti, edhe pse duhet ta shqyrtojë interpretimin shkencor të ngjarjeve historike, megjithatë kjo do duhet të realizohet nën mbikëqyrjen e Ministrive të Punëve të Jashtme të të dyja vendeve - raporton "Alsat M". "E uroj Maqedoninë për vendimin historik. Të vazhdojë me implementimin e Marrëveshjes së Prespës, me çka dërgoi sinjal të inkurajimit ju vetëm për Maqedoninë, por edhe për tërë rajonin", ka thënë kancelari austriak, Sebastijan Kurc.



Presidenti i Maqedonisë, Gjeorgje Ivanov

GJEORGJE IVANOV

"Me Marrëveshjen e Prespës, veprimtarinë tuaj akademike dhe arsimore do ta mbikëqyrin politikanë, diplomatë dhe burokratë, të cilët do t'i censurojnë librat që shkruani apo prej të cilave ju ligjëroni", - tha Ivanov.

SEBASTIJAN KURC

"E uroj Maqedoninë për vendimin historik. Të vazhdojë me implementimin e Marrëveshjes së Prespës, me çka dërgoi sinjal të inkurajimit ju vetëm për Maqedoninë, por edhe për tërë rajonin", ka thënë kancelari austriak, Sebastijan Kurc.

tu është shprehur ditën e djeshme kancelari austriak, Sebastijan Kurc, i cili së bashku me presidentin malazez,

Millo Gjukanoviq hapi konferencën "Ballkani dhe BE-Ja - Cikli pesëvjeçar i procesit të Berlinit", që mbahet në Bud-

va. Në konferencë merr pjesë delegacioni qeveritar i Maqedonisë, i udhëhequr nga zëvendëskryeministri për Çështje Ekonomike, Koço Angjushhev e në përbërje të të cilit është edhe ministri i Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi. Angjushhev, siç kumtoi Kabineti i tij, do të marrë pjesë në panelin "Perspektiva ekonomike dhe evropiane e Ballkanit" dhe do të debatohet me përfaqësuesit e tjerë të shquar politik nga vendet e rajonit. Bekteshi ndërkaq, nesër do të marrë pjesë në panelin "Bashkëpunimi rajonal si segment i integrimi evropiane: ekonomia-generatori i zhvillimit të tërësishëm", së bashku me ministrat tjerë ekonomik nga ra-

Zjarret rrezikojnë Greqinë, guvernatori: Shpallet gjendja emergjente

Vijojnë situatat alarmante në zonat bregdetare të Greqisë. Ditën e djeshme një zjarr i madh ka përfshirë zonën Halkidiki orët e para të mëngjesit, ndërsa vazhdon pa rezultat beteja me flakët edhe pasdite në Sithonia Halkidiki. Guvernatori i periferisë së Maqedonisë Qendrore, Apostolos Xhixhikostas ka kërkuar të shpallen në situatë emergjente qyteza e Sartit dhe zona përreth. Shkollat nuk kanë funksionuar, ndërsa banorët që qëndrojnë të mbrojnë shtëpitë janë lajmëruar për evakuim të mundshëm me varka që janë gati. Zjarri ka nisur në orën 05:40 në një zonë pyjore të thellë e të virgjër. Është përhapur me shpejtësi nga erërat e fuqishme dhe duket e vështirë të vihet nën kontroll. Është ndërprerë dhe qarkullimi në rrugën Vurvuru-Sikias, ndërsa luftojnë me flakët 80 punonjës të zjarrfikësës, 4 aerokafe, 2 helikopterë dhe 4 grupe civilësh. Ndërkohë, erërat e fuqishme kanë ndezur një tjetër vatër në Agios Athanasios, po në periferi të Selanikut. Situata këtu duket të jetë nën kontroll.

SITUATA EMERGJENTE

Është ndërprerë edhe qarkullimi në rrugën Vurvuru-Sikias, ndërsa luftojnë me flakët 80 punonjës të zjarrfikësës, 4 aerokafe, 2 helikopterë dhe 4 grupe civilësh. Ndërkohë, erërat e fuqishme kanë ndezur një tjetër vatër tani pasdite në Agios Athanasios, po në periferi të Selanikut.

joni. Kancelari Kurc në fjalimin e tij u përgjendrua në aspektet e ndryshme, të cilat ndikojnë në stabilitetin më të madh ekonomik dhe të sigurisë në rajon. Ai theksoi se rajoni sot me guxim ecën përpara me proceset reformuese

dhe bëhet faktor kredibil për tërë Bashkimin Evropian. Në kuadër të konferencës, anëtarët e delegacionit qeveritar do të realizojnë edhe takime bilaterale me liderët politikë dhe të biznesit nga rajoni.

Çfarë po ndodh në SHBA? Rrezikohet me jetë grupi "anti-Donald Trump"


Pakoja e katërt me eksplozivë, kërcënohet aktori Robert De Niro

Në 6 nëntor zgjedhjet e mesmandatit, 'gjendet' autori i bombave

Vijon zinxhiri i vënies së bombave nëpër vendbanimet e disa prej figurave më të njohura në Amerikë. Një pako e dyshimtë është gjetur ditën e djeshme në restorantin "Tribeca", në pronësi të aktorit të njohur të Hollywood, Robert De Niro, ka raportuar "New York Post". Të gjithë njerëzit që ndodheshin në restorant u evakuuan menjëherë me ardhjen e forcave të policisë. Pakoja ishte po e njëjta si ato me eksplozivë të gjetur në shtëpitë e ish-Presidentëve Barack Obama e Bill Clinton. Po ashtu ditën e mërkurë, një tjetër pako u gjet dhe në redaksinë e agjencisë amerikane CNN dhe në shtëpinë e George Soros ditën e hënë. Ajo çfarë i bën të përbashkët të gjitha vendet në të cilat është vënë pako e dyshimtë me eksplozivë, është fakti se të gjithë janë anti-Donald Trump, shkruajnë mediat amerikane. Kjo histori ka nisur këtë të hënë me një pajisje të dyshuar shpërthyesë të dërguar në adresën e shtëpisë së donatorit miliarder liberal, George Soros, në Nju Jork. Autoritetet amerikane u angazhuan menjëherë që prej së mërkurës, me një hetim gjithëpërfshirës mbi atë se kush fshihet pas bombave artizanale në formë tubi, të dërguara në adresat e ish-presidentit Barack Obama, ish-kandidates demokrate të presidentit Donald Trump. Por nuk kanë vonu-



Aktori Robert De Niro



4 pako

EKSPLOZIV

Të paktën 4 pako të dyshimta u dërguan në Nju Jork, Uashington dhe Florida, drejtuar madje edhe figurës së shquar afro-amerikane, ish-kryeprokurorit Eric Holder të epokës "Obama", por edhe ndaj Maxine Waters, një ligjvënëse nga Kalifornia. Paket e dërguara kishin që të gjitha një emër dërguesi: Debbie Wasserman Schultz, ish-kryetare e Komitetit Kombëtar Demokratik. Ndërkohë, adresat e kthimit përfshinin edhe gabime drejtshkrimore të mbiemrit të Wasserman Schultz, siç raportojnë mediet amerikane, përfshi "Miami Herald".

DONALD TRUMP:

"Aktet e dhunës politike nuk kanë vend në Shtetet e Bashkuara. Ata që janë të angazhuar në fushën politike duhet të ndalen së trajtuar kundërshtarët politike si moralisht të dëmtuar. Media ka, gjithashtu, përgjegjësinë për t'i dhënë tonin dhe për t'i dhënë fund armiqësisë së pafundme dhe vazhdimisht negative, e sulmeve apo ngjarjeve shpesh false. Ato duhet të ndalen", -ka thënë Trump.

ar edhe aludimet për të drejtuar gishtin tek i ashtuquajtur i fajtori i këtyre bombave. Kanë qenë pikërisht kritikët e Trump, ata të cilët akuzuan kreun e Shtëpisë së Bardhë se po inkurajon dhunën, vetëm pak ditë përpara se

Amerika e përçarë dukshëm të votojë në zgjedhjet e mes-mandatit, më 6 nëntor. Ndërkaq nuk ka vonuar as reagimi i presidentit të SHBA-së, Trump fillimisht u bëri i rrëzë për unitet dhe më pas duke sulmuar sërish

mediat për "armiçësinë e saj të pafundme". Të paktën 7 pako të dyshimta u dërguan në Nju Jork, Uashington dhe Florida, drejtuar madje edhe figurës së shquar afro-amerikane, ish-kryeprokurorit Eric Holder të epokës

"Obama", por edhe ndaj Maxine Waters, një ligjvënëse nga Kalifornia. Paket e dërguara kishin që të gjitha një emër dërguesi: Debbie Wasserman Schultz, ish-kryetare e Komitetit Kombëtar Demokratik. Ndërkohë, adresat e kthimit përfshinin edhe gabime drejtshkrimore të mbiemrit të Wasserman Schultz, siç raportojnë mediet amerikane, përfshi "Miami Herald". Nga Shtëpia e Bardhë, Trump apeloj fillimisht për unitet, duke thënë se "aktet e dhunës politike nuk kanë

vend në Shtetet e Bashkuara". "Ata që janë të angazhuar në fushën politike duhet të ndalen së trajtuar kundërshtarët politike si moralisht të dëmtuar", -theksoi më pas ai gjatë një mitingu në Wisconsin, përpara se t'u rikthejë kritikave ndaj medias. "Media ka, gjithashtu, përgjegjësinë për t'i dhënë tonin dhe për t'i dhënë fund armiqësisë së pafundme dhe vazhdimisht negative, e sulmeve apo ngjarjeve shpesh false", shtoi ai. "Ato duhet të ndalen".

Parlamenti Evropian voton 'pro' heqjes së plastikës njëpërdorimshme

BE: Ndalohet prodhimi i 10 materialeve të dëmshme

Ndotja e habitatit ku je ntojmë sa vjen dhe bëhet më e madhe dhe situatë duket se ka arritur pikat alarmante. Për këtë arsye Bashkimi Evropian ka hedhur një hap të fortë drejt frenimit të ndotjes për një të ardhme më të qëndrueshme. Ditën e mërkurë, më 24 tetor 2018, Parlamenti Evropian miratoi ndalimin e plastikës njëpërdorimshme si gota, pjata, pirunë, thika, pipa dhe kunjat veshësh plastike, të cilat do të hiqen nga tregu evropian deri në 2021. Këto produkte përbëjnë mbi 70% të mbeturinave detare. Për shkak të shkallës së ulët të dekompozimit, plastika grumbullohet në dete, oqean dhe në plazhe në BE dhe në mbarë botën. Mbetjet e



plastikës gjenden në specie detare, të tilla si peshqit dhe gjallesat e tjera detare dhe më pas kalojnë prandaj në zinxhirin ushqimor të njeriut. Sipas Komisionit Evropian, më shumë se 70% e mbeturinave detare janë plastike. Në bazë të shumë kërkimeve dhe studimeve, shumë mikrocopëza plas-

tike arrijnë të hyjnë në mishin e peshkut të ngrënë nga njerëzit. Plastika e gjetur në organizmat njerëzore prej konsumit të peshkut të ndotur përmban

70%:
MBETURINA
Mbetjet e plastikës gjenden në specie detare, të tilla si peshqit dhe gjallesat e tjera detare dhe më pas kalojnë prandaj në zinxhirin ushqimor të njeriut. Sipas Komisionit Evropian, më shumë se 70% e mbeturinave detare janë plastike.

2021
AFATI
Parlamenti Evropian miratoi ndalimin e plastikës njëpërdorimshme si gota, pjata, pirunë, thika, pipa dhe kunjat veshësh plastike, të cilat do të hiqen nga tregu evropian deri në 2021

qimin njerëzor. Studiuesit vunë në dukje se ishte vlerësuar se konsumatorët evropianë të frutave të detit mund të konsumojnë deri në 11,000 copa mikroplastike në vit. Por ka kufizime edhe për produkte të tjera plastike. Konsumi i disa artikujve të tjerë, për të cilët nuk ekziston asnjë alternativë, do të duhet të reduktohet nga shtetet anëtare prej më së paku 25% deri në vitin 2025. Kjo përfshin kutitë plastike me një përdorim ose kutitë që përdoren për fruta, perime, ëmbëlsira ose akulllore. Shtetet anëtare, por edhe Shqipëria, do të hartojnë plane kombëtare për të inkurajuar përdorimin e produkteve të përshatshme për përdorim të shumëfishtë, si dhe përdorimin dhe riciklimin.

copëza najloni, polistireni dhe polietileni. Studime të tjera kanë treguar se midjet dhe butakët e detit janë një burim edhe më i madh i mikroplastikës në ush-

KONKURSI INTERVISTA

Intervistë ekskluzive për "GSH" e prof. Alberto Frashëri, që jeton prej gati 30 vitesh në Romë, për librin e tij të fundit

"Me romanin 'La Quinta' tentojmë të paraqes realitetin shqiptar në diktaturën komuniste"

Romani "La Quinta" është përzgjedhur ndër pesë finalistët për t'u shpallur fitues nesër, më datë 27 tetor

Nga Dashnor Kaloçi

Konkursi "Premio Letterario Internazionale - La Pergola d'Arte 2018", edicioni X, Firenze, që organizohet nga shoqata kulturore "La Pergola d'Arte" (Firenze), është një konkurs ku editorët mund të paraqesin vepra letrare, si: poezi, tregime, ese dhe romane të llojeve të ndryshme dhe aty marrin pjesë autorë të ndryshëm nga e gjithë bota. Ambienti dhe tradita kulturore e krahinës së Toskanës dhe Firences në veçanti e kanë transformuar këtë event të botës së artit në një synim të dëshiruar të njerëzve të botës letrare. Këto ditë juria e konkursit botoi 'online' emrat e finalistëve të konkursit, ceremonia e të cilit do të bëhet në 27 tetor në auditorin e shoqatës në Firenze. Konkurrimi në këtë aktivitet bëhet në disa seksione, ndër të cilat ajo e prozës së gjatë (romanit) është nga më të rëndësishmet. Aty marrin pjesë shkrimtarë italianë dhe të huaj. Mund të përmendim disa emra të njohur si: W. D. Carrino me romanin "Il segreto del Volo", J.C. Casalin me librin "Generazione Arcobaleno" etj., por e veçanta e këtij aktiviteti është pjesëmarrja e një shqiptari, prof. dr. Albert Frashëri, me origjinë nga Shkodra, i cili prej gati 30 vitesh jeton dhe punon në Itali. Prof. Frashëri konkurron në këtë event me romanin "La Quinta" dhe përfshirja e tij në 5 finalistët e këtij konkursi të rëndësishëm, mendoj se ka një rëndësi të veçantë jo vetëm për atë si autor, por edhe për botën shqiptare. Kjo për disa arsye. Së pari, sfondi historik i ngjarjeve të rrëfyerave në romanin "La Quinta" i përket periudhës së regjimit komunist që kombi shqiptar vuajti për gjysmë shekulli. Së dyti, argumenti



Prof. Alberto Frashëri

i trajtuar me kujdes nga autori nuk është thjesht një kronikë e historisë, por konflikti i ashpër ndërmjet lirisë së qytetarit dhe pushtetit si një formë e skajshme e totalitarizmit të shekullit XX etj. Kjo e dyta i jep një vlerë universale në kohë e në hapësirë romanit "La Quinta", sepse totalitarizmi nuk karakterizon identitetin e një kombi. Ai është thjesht një formë e degjeneruar dhe pushtetit. E veçanta e rastit shqiptar është dimensionin dhe egërsia e pafund e dhunës, me siguri një nga më të urryerit që popujt evropianë kanë njohur. Por, për të pasur një ide më të qartë rreth këtij romani, ne ju drejtuam për një intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare", vetë prof. Frashëri, i cili pranoi me kënaqësi.

Profesor Frashëri, romanin tuaj rrëfen jetën e një grupi artistësh nën regjimin totalitar në Shqipëri, duke vënë në plan të parë represionin e diktaturës. Cili ka qenë objekti apo synimi i tuaj i vërtetë në këtë libër që botohet në Itali tri dekada pas rënies së atij regjimi?

Pas rënies së nazifashizmit, arti me format e shumta të tij e ka rivizituar realitetin dhe vuajtjet e shkaktuara nga dy prej totalitarizmave më mizore të historisë. Në rastin e regjimeve totalitare të Lindjes Europiane, përkundrazi, mbretëron një heshtje relative e pafalshme. Nuk janë nostalgjitë për regjimet totalitare që mund ta shpëtojnë botën. Nuk mund të jetë as propaganda e partive që mund ta thellojë njohjen e së "Vërtetës mbi të Keqen Absolutë të shekullit XX". Vetëm arti, me të gjitha format shprehëse të tij do të mund t'u transmetojë breznive të reja të vërtetën historike bashkë me tragjedinë e vuajtjes njerëzore të popujve evropianë.

Universi dhe natyra, misterit i të bukurës dhe drita e urtësisë, paqja si shprehje e ekuilibrit dhe harmonisë nuk kanë kombësi. E dinë mirë artistët që në aftësinë krijuese shohin magjinë e natyrës dhe, në një farë kuptimi, pavdekësinë e njeriut. Për këtë bindje dhe ndjeshmëri fisnike artistët janë viktimat e para të regjimeve diktatoriale. Ashtë ky sfon-

di historik i romanit "La Quinta", në të cilin jam përpjekur të rrëfej dramën reale të një grupi artistësh që e vuajtjen dhunën fizikisht e shpirtërisht, por pa tradhtuar aspak bindjet dhe ndjeshmëritë e tyre fisnike. Nga kjo pikëpamje ata janë heronj të vërtetë të asaj periudhe obskurantiste, që shumë prej sivilëzëve tanë nuk njohin ose po harrojnë.


Introduksioni apo hyrja e librit i ngjan një eseje. Cili është mesazhi që ju kenit dashur të transmetoni me atë hyrje?

E shkruajta këtë roman jo si një realitet që karakterizon botën shqiptare, sepse atë eksperiencë e kanë përjetuar edhe kombe të tjera, kush më shumë e kush më pak. Ajo përvojë tregoi që totalitarizmi ashtë formë me ogurzezë e pushtetit që historia moderne ka njohur. Objekti apo argumenti kryesor i këtij libri ashtë konflikti midis artit dhe pushtetit, që në rastin e regjimeve totalitare arrin format më të dhunshme e më absurde. Kjo ndodh sepse pushteti kudoherë përpiqet të dominojë hapësirën që e ndan nga arti dhe shkolla. Arti dhe shkoll-


la janë ato që e bëjnë të paruar qytetarin, pra të aftë të mos bjerë në grackën e propagandës, por të gjykojë më objektivitet realitetin. Në rastin e totalitarizmave ky konflikt arrin shkallën më të lartë. Kjo rrethanë duhet të na bindë për rolin e madh që kanë shkolla dhe arti në jetën e një kombi. Sot, me që ra fjala, ideja për të shkatërruar teatrin e parë të rëndësishëm të vendit është e papranueshme, sepse ai teatër dëshmon veprën e shquar të një plejade artistësh për kulturën kombëtare. Historia ka kulturën si udhërrëfyes, si frymëzues dhe si thelb të ekzistencës së një kombi. Ekonomia dhe të tjera fusha janë instrumente për të pasuruar kombin në të gjitha pamjet që kultura na ofron. Romani "La Quinta" i kush-tohet pikërisht këtij konflikti mes formave të devijuarra të pushtetit dhe kreativitetit të shoqërisë. Ky fenomen universal në kohë dhe në hapësirë dhe nuk i përket vetëm botës shqiptare.

Librin, me një sfond historik të pasur me ngjarje nga bota shqiptare, ju e kenit shkruar në Italisht dhe e botuat në Romë. Pse pikërisht në Italisht dhe jo në shqip?

Shumë qytetarë e njerëz të shquar të artit në Shqipëri kanë punuar mjaft në këtë drejtim. Janë shkrimtarë, publicistë, muzikantë, piktorë etj. Unë jetoj në Itali dhe shoh që edhe atje, si në të gjitha shtetet perëndimore, ka nevojë të njihen disa karakteristikë të totalitarizmit që janë trajtuar më pak, sidomos në art e letërsi. Psh., Musolini i detyroi profesorët të deklarojnë me shkrim besnikërinë ndaj fashizmit. Nuk ia kërkoi teknikun, inxhinierit apo ekonomistit, por thjesht njerëzve që ndikojnë formimin kulturor të qytetarit. Funkcionin edukativ të shkollës dhe të artit, ai donte ta vinte në shërbim të ideologjisë fash-



iste. Ata që nuk e deklaruan atë besnikëri, u flakën nga shkolla. Pikërisht këto aspekte të totalitarizmit janë më pak të rrahura. Së dyti, bota perëndimore ka propaganduar me të drejtë kundër totalitarizmit të majtë, por propaganda nuk ashtë në gjendje të zëvendësojë atë që mund të bëjë arti dhe letërsia. Historia formale na jep një kronikë të vyer e absolutisht të nevojshme ngjarjesh mbi evolucionin e shoqërisë, por këto mbeten larg dhimbjes njerëzore, pasioneve dhe meditimeve individuale. Ne jemi në gjendje të dallojmë njeriun e Romës së lashtë nga ai i kohës sonë vetëm në sajë të veprave që arti na ka sjellë: poezia, drama, romani, muzika, piktura etj. Në këtë det të pafund, unë desha të shtoj diçka nga realiteti shqiptar: forcën dhe fisnikërinë me të cilën shqiptarët përballuan një nga format më të urryera e mizore të totalitarizmit. Përvoja shqiptare jep një kontribut të pamashë në njohjen e totalitarizmit të majtë, pra mendoj që duhet njohur nga bota dhe nga brezat e rinj në Shqipëri. Romani e shkruajta në italisht, sepse jetoj atje prej gati 30 vjetësh dhe sepse ky argument u intereson të gjitha →



← vendeve.
Ngjarjet në libër janë kryesisht nga Shkodra në Tiranë. A ka diçka reale në personazhet dhe ngjarjet që tregoni?

Ky roman rrëfen ngjarje reale e që shqiptarët njohin mirë, por me personazhe të krijuara nga autori. Natyrisht, kush i ka jetuar ato vite, në personazhet kryesore të librit do të gjejë modele të ngjashme me artistët të njohur. Ajo që lexuesi i brezit tim gjen në atë libër është ndjenja e frikës dhe pasigurisë që shoqëronte jetën tonë nga lindja deri në vdekje. Përkundrazi, lexuesi i ri, që fatmirësisht nuk e ka njohur atë regjim satrap e absurd ka nevojë të njohë mirë atë formë të pushtetit arbitrar e despot për të evituar që në të ardhmen ai mjerim të përsëritet. Në roman ka disa drama kryesore që lidhen me një grup artistësh, miq mes tyre e të talentuar. Në jetë e në punë ata survejohen nga policia politike, në të cilën një ish-shok shkollë i tyre bën karrierë dhe ka si detyrë të vëzhgojë ambientet artistike të qytetit. Njëri prej artistëve, basi lirik Marin Kraja, ishte kundër heqjes së veprave të klasikëve të muzikës botërore nga repertori i Teatrit të Operas dhe Baletit.

Ai u përjashtua nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve dhe iu dha gjykatës për dënim. Të njëjtin fat pësoi edhe piktori i talentuar Naim Bregu, që u akuzua si modern dhe i papajtueshëm me ideologjinë e regjimit. Ky u dënua rëndë nga gjykata. E shoqja e këngëtarit iu nënshtrua fatit dhe nuk e braktisi të shoqin, edhe pse iu desh të punonte për bukë e gojë në një fermë bujqësore. Përkundrazi, e shoqja e piktorit e fshiu nga jeta e vet të shoqin. Këto diferencë në njohim mirë. Dhuna arrinte deri sa të tjetërsonte deri edhe dashurinë, miqësinë apo të ndante familjet. Personazhi kryesor dhe më kompleks është ai i një instrumentisti dhe kompozitori të ri, Fran Kola, që ka sukses, por presioni i regjimit ia vështirëson jetën dhe e godet pikërisht në veprën e tij më të mirë, "Poema e Paqes", një koncert për trombë dhe orkestrë në Do Maxhor. Epilogu i romanit ka një farë spiritualizmi në mënyrën se si Frani e gjen shpëtimin. Një shpëtim virtual, që e gjeti arsyes në bukuritë e kësaj jete: dashuria, natyra, liria dhe muzika.

Kopertina paraqit basorelievin e Rozafës të skulptorit Skënder Kraja.



Është e rastit kjo zgjidhje, apo lidhet me përmbajtjen e romanit?

Jo, nuk është e rastit. Libri hapet me legendën e Rozafës dhe mesazhin e saj, që në thelb shoqëron nga kreu deri në fund një ide që jam përpjekur ta përpunoj në libër. Heronjtë e romanit krijojnë veprat e tyre, edhe pse në kushte të lirive shumë të kufizuara. Ata e pyesin veten si ashtë e mundur që edhe në mjerim e në robëri, njeriu të krijojë. Liria është ajo që i jep krahë krijimtarisë njerëzore në të gjitha format e saj. Por, edhe në historinë e regjimeve despote, njeriu ka krijuar në të gjitha fushat. Kjo e vërtetë gjen në legendën e Rozafës një maksimumin absolut, edhe pse në pamje absurde. Rozafa që porsa kishte lindur, kur i thanë që do e flijonin nuk kërkoi jetën, por u lut ta varrosnin pjesërisht duke i lanë një sy, një gjë dhe një dorë jashtë që të mund të kujdesej për fëmijën, krijesën e saj. Pra, një mesazh, që edhe pse makabër, ashtë nga format më njerëzore, tragjike dhe bindëse për forcën e krijimtarisë të njeriut: gruaja që edhe pas vdekjes përpiqet t'i japë jetë krijesës së vet. Pikërisht këtë mesazh të asaj legjende hyjnore, për thelbin që shpreh, desha ta vendos në piedestalin e njërës prej ideve kryesore të romanit: vendosmëria dhe forca krijuese e njeriut janë të pashyeshme. Ajo i përket natyrës njerëzore dhe nuk ka totalitarizëm që ta asgjësojë. Njeriu ashtë një krijesë e natyrës, ndërsa totalitarizmi ashtë një tjetërsim i urreyer i natyrës njerëzore. Jeta e ka konfirmuar këtë të vërtetë: ithtarët dhe liderët e totalitarizmit e kanë përfunduar jetën të dështuar si frikamanë, të dënuar e të urreyer nga njerëzimi. Në këto rrethana meditative më lindi e natyrshme dëshira për të vendosur në kopertinë basorelievin e Rozafës, gjë që ma bëri të mundur me shumë fisnikëri autori i basorelievit, profesori Skënder Kraja.

Titulli "La Quinta" tërheq vëmendjen. Çfarë shpreh dhe si do të ishte në gjuhën shqipe?

Këtë roman fillimisht e pata titulluar "Il sogno di un musicista", pra "Ëndrra e një muzikanti". Ky titull ishte një shprehje domethënëse e epilogut të romanit. Nga ana tjetër, muzika në këtë libër ka një rol të veçantë. Ajo përbën një farë sfondi që, sipas mendimit tim, harmonizohet mrekullisht me përmbajtjen. Heroi i romanit, Fran Kola, pas goditjes që merr nga regjimi, ka një ide kah vetëvrasja dhe sjell ndërmend fundin tragjik të Preng Jakovës. Në ato ditë të vështira, mendja e tij virtualisht interpretohte muzikën e simfonisë së pestë të Bethovenit si një ekuivalent shpirtëror dhe moral i jetës dhe pikëpamjeve të tija. Ai e braktis idenë e vetëvrasjes. Dashuria për shoqen e jetës, Rudinën, magjia e natyrës,

dytë, që rrëfen jetën shqiptare gjatë regjimit totalitar të Hoxhës. Çfarë diferencë ka ndërmjet këtyre dy librave, ose çfarë të reje sjell njëri kundër tjetrit?

Hannah Arendt ka shkruar shumë për totalitarizmin dhe jo vetëm ajo. Kjo filozofe gjermane, emigruar në USA, ka njohur mirë nazimin dhe tragjedinë e Luftës së Dytë Botërore. Atë tragjedi dhe ideologjinë përkatëse ajo i ka trajtuar në aspektet filozofike. Nga ana tjetër, shumë artistë e kanë trajtuar të njëjtin problem me instrumentet që arti ofron. Sipas mendimit tim, problemi i totalitarizmit si formë e devijuar e pushtetit (ideologji e praktikë) ashtë gjithmonë aktual. Nëse ne duam të evitojmë praninë e një tirani në historinë tonë,



ajri i pastër i malit, muzika e kësaj simfonie dhe fluturimi i një shqiponje, që çuditërisht shoqëron shëtitjen e tij në mal krijojnë një atmosferë spirituale në të cilën Frani rigjen qartësinë dhe forcën për të mbijetuar.

Muzika ishte jeta dhe forca e tij. Për këtë arsye mendova që kjo simfoni t'i japë titullin romanit. Në italisht titulli i shkurtuar qëndron, madje ashtë i bukur, "La Quinta" dmth., "E pesta". Për një version të këtij titulli në shqip, nëse kjo do të jetë e nevojshme, do të doja të konsultoj miq të mi muzikantë dhe gjuhëtarë.

Ky është romani juaj i

forcat ekstremiste po fuqizohen. Cili njeri mund të konfirmojë që kjo gjendje nuk ka rreziqe për demokracitë perëndimore? Qytetarët duhet të jenë të vetëdijshëm për rreziqet që sjellin situata të tilla.

Shkolla dhe arti duhet të punojnë në këtë drejtim. Në rastin e dy librave të mija çfarë mund të themë I pari, "L'amara favola albanese", tregon një realitet të dhunshëm nga pikëpamja dhe ndjeshmëria e një të riu, nga fëmijëria deri në përfundimin e studimeve universitare. Ai vëzhgon, mediton dhe dëshmon hipokrizinë e një sistemi absurd. Përkundrazi, romani "La Quinta" ka një hapësirë ngjarësh, një sfond historik e personazhe në të cilat jam përpjekur të rrëfej një nga konfliktet e shumta të regjimeve totalitare me shoqërinë: persekutimi i intelektualëve dhe njerëzve të fesë, censura e dhunshme e artit dhe madhështia e njeriut, që e vuajti fizikisht dhe shpirtërisht atë regjim pa tjetërsuar aspak thelbin e tij; dëshirat, miqësitë, pasionet dhe bindjet. Jo të gjithë janë të vetëdijshëm për forcën që kombi shqiptar tregoi në atë gjysmë shekulli. E varfëruan në palcë, e internuan pa gjyq, e dënuan për një fjalë goje, por ai nuk e humbi fisnikërinë e tij. Ndoshta Shqipëria ashtë vendi i vetëm në të cilin asnjë ish-i dënuar apo i internuar për dekada me pleq e fëmijë që u rritën rrethuar nga telat me gjemba nuk ka tentuar të vrasë apo të hakmerret kundër njerëzve të atij regjimi.

Një pyetje të fundit, a e keni menduar botimin në shqip të këtyre dy librave?

Po, e kam menduar, por nuk kam pasur asnjë sinjal apo interes nga ana e editorëve. Nëse kjo do të konsiderohet e dobishme, atëherë duhet parë problemi i përkthimit. Profesoresha e letërsisë italiane, Loretta Santini, më shkruante këto ditë: "Me ka tronditur leximi i këtij romani. Edhe shkollat duhet ta studiojnë atë...". Dua të shtoj dhe e mbyll, që romani "L'amara favola albanese" është përfshirë shpeshherë në programet e letërsisë si lexim komplet për njohjen e totalitarizmit të shekullit XX. Ai libër gjendet në një numur shumë të madh bibliotekash nacionale, universitare, krahinore, si dhe në kataloget e librave shkollorë. Pra, problemi i botimit në shqip nuk varet nga unë, edhe pse ai botim do të më jepte një kënaqësi të veçantë.

Së fundi, duke ju falënderuar profesor, ju urojmë suksese në konkurrimin e këtij libri, që zhvillohet nesër, në datën 27 tetor.

Faleminderit juve personalisht, por gjithashtu edhe "Gazeta Shqiptare", që gjeni mundësi dhe trajtoni tema të tilla, edhe për në shqiptarët që jetojmë, punojmë, por edhe krijojmë prej vitesh larg atdheut.

INTERVISTA

PERSIDA ASLLANI:

Për koleksionin e rrallë me 1200 njësi, 1493-1940

Fatmira Nikolli

Rrëfimet e një koleksioni albanologjik, Shqipëria dhe shqiptarët nga Skënderbeu tek Pavarësia” prej ditës së hënë ekspozohet në Muzeun Kombëtar, duke paraqitur një koleksion mjaft të gjerë me libra, harta, revista, gravura. Pasi shfaq 300 nga 1200 njësi që ruan, Ylli Sula, 200 vepra i ka vënë në dispozicion të Bibliotekës Kombëtare, e cila do t'i digjitalizojë për t'i bërë pjesë të koleksionit të vet digjital meqenëse janë tituj që i mungojnë. Event i organizuar në kuadër të Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriot Skënderbeut ka larmishmëri librash, epoka që ngërthehen e tituj që trajtojnë tematika të pasura. Koleksioni përfshin harkun kohor të shekujve XV - XIX, shkruar për Shqipërinë dhe shqiptarët.

Drejtori i Muzeut Historik Kombëtar, Dr. Dorian Koçi vëren se “Borhesi në veprën e vet monumentale “Biblioteka e Babelit” rrëfen sesi universi konsiston në hapësira dhomash hegzgonale të stërmëdha, të cilat përfshijnë dijet e mjaftueshme për të mbijetuar njerëzimi si dhe katër dhoma të mëdha me rafta librash. Ndaj, rrëfimet e një koleksioni albanologjik me Shqipërinë dhe shqiptarët nga Skënderbeu tek Pavarësia si pjesë e koleksionit të studiuesit Ylli Sula sjell një tjetër anë përmes një koleksioni unik librash, hartash dhe gravurash të vjetra të shekujve XV-XIX, që ekspozohen për publikun për herë të parë.

Në kuadër të saj, u mbajt edhe një konferencë shkencore me kumtesa albanologjike të studiuesve: Aurel Plasari, “Skënderbeu në dashurinë e një bibliofili”; Xhevat Lloshi, “Visaret befasuese të një koleksioni të rrallë”; Skënder Blakaj, “Kontributi shqiptar i Papë Albanit, përfshirë kryeveprën ‘Illyricum Sacrum’ dhe Skënderbeu”; Pëllumb Xhufi, “Epiri dhe Kosova në literaturën historike të shek. XV-XVII”; Irakli Koçollari, “Një epokë dhe një personazh që pruri në vëmendjen e Europës dhe më gjerë Shqipërinë dhe shqiptarët”; dhe Dorian Koçi: “Grand Tour”. Udhëtimet dhe zonjat angleze në Shqipëri”. Në këto kumtesa u trajtuan me detaje dhe me hollësi pjesët më të rëndësishme të koleksionit të Ylli Sulës, sesi këta libra ndërthuren për të krijuar një panoramë të përgjithshme të studiuesve historike në Shqipëri.

“Ideja e hershme për një seri takimesh në Bibliotekën Kombëtare dhe mjetet modeste ekspozuese që nuk mundën ta mirëprisnin”



Ylli Sula, Dorian Koçi dhe Persida Asllani

Ndërkaq, në një intervistë për “GSH”, Persida Asllani, drejtoreshë e Bibliotekës Kombëtare, tregon një projekt të hershëm të mbetur në sirtar, për shkak të mungesës së hapësirave në BKS. Ajo flet për koleksionin dhe koleksionistin, si për një pasuri të paçmuar.

“Zonja Asllani, të hënën ju hapët në mjediset e Muzeut Kombëtar ekspozitën me antikuare të Ylli Sulës, me titull “RRËFIMET E NJË KOLEKSIONI ALBANOLOGJIK: Shqiptarët dhe Shqipëria nga Skënderbeu tek Pavarësia”. Përse u çel në Muze e jo në Bibliotekë kjo ekspozitë?”

Pasditen e së hënës, drejtori i Muzeut Kombëtar Dorian Koçi dhe unë, në cilësinë e drejtores së Bibliotekës Kombëtare, iu uruam së bashku mirëseardhjen të ftuarve të shumtë të kësaj ceremonie

Një pjesë e rëndësishme e këtij koleksioni dhe të librave që mungojnë në Bibliotekën Kombëtare do të digjitalizohen dhe do t'i dhurohen Bibliotekës Kombëtare. Në këtë mënyrë, studiuesit e disiplinave të ndryshme shkencore e historike do të kenë mundësi për t'i trajtuar në studimet e tyre.

partnerë dhe faktorë të rëndësishëm në pasurimin e rrjetit kombëtar të trashëgimisë kulturore. Dhe këtë, ata e bëjnë “pa buxhetin e shtetit”, por me të ardhurat, dijen dhe pasionin e tyre. Mbi të gjitha, kemi vlerësuar si të rëndësishme të skajshme faktin se këto koleksione akumulohen e ruhen më së shumti në territorin shqiptar.

Pra, ka pasur një vëmendje më të hershme për koleksione dhe ekspozime të tilla?

Po. Prej kohësh në Bibliotekën Kombëtare patëm ideuar zhvillimin e një serie ekspozitash në titullin: “Koleksionistë në Bibliotekë”, me koleksione koleksionistësh të ndryshëm, ku një prej ekspozitave të parave do të ishte pikërisht “rrëfimi” pasionant i Ylli Sulës. Por, qysh prej 4 viteve më parë, ai e pasuroi koleksionin e tij duke e shumëfishuar në mënyrë marramendëse. Më ngjan sikur mendja e Ylliit ka funksionuar njësoj me atë të benediktinit mistik të fundshekullit XV, Johannes Trithemius, i cili, në veprën “De laude scriptorium” të vitit 1492 shkruante: “nuk ekziston në këtë botë kurrfarë ligji që të pengon të zotërosh sa më shumë libra”...!

Prandaj mjediset dhe mjetet modeste ekspozuese të BKSH nuk mund ta mirëprisnin më ashtu, siç dhe i takonte një koleksioni të tillë. Sqaroh se bëhet fjalë për një koleksion albanologjik me gjithsej 1200 njësi (nga viti 1493 në Luftën II Botërore), ku përfshihen inkunabula, libra antikuare, dorëshkrime, harta, gravura, revista etj. Ylli Sula ekspozoi kësaj here, me krenari të merituar, rreth 300 prej tyre. Mendoj se hapësira e dedikuar këtu ditë në Muzeun Kombëtar i jep dinjitetin që meriton këtij koleksion mbresëlënës dhe drejtuesi i tij, Z. Koçi, meriton fjalët më të mira për mbështetjen e pakursyer që i dha këtij projekti qysh në zanafillë.

A gjenden në koleksionin e Sulës, libra e materiale që nuk i ka Biblioteka Kombëtare?

Koleksionet tona albanologjike janë mjaft të pasura, megjithatë tashmë kemi evidentuar rreth 220 njësi që na mungojnë dhe së shpejti do të fillojë puna për digjitalimin e tyre nga ana e Bibliotekës Kombëtare. E falënderoj publikisht zotin Ylli Sula për këtë gjest, falë të cilit Fondi digjital i Bibliotekës



Kombëtare pasurohet edhe më tej. **Atë ditë u prezantua edhe një katalog elegant po me titullin “RRËFIMET E NJË KOLEKSIONI ALBANOLOGJIK: Shqiptarët dhe Shqipëria nga Skënderbeu tek Pavarësia”. Katalogu të tillë në shqip janë të rrallë, apo jo?**

Po. Eshhtë i rëndësishëm fakti i botimit të një katalogu që shpëron dhe shpjegon koleksionin e ekspozuar. Një katalog i mirë bashkon hijeshinë dhe joshjen e imazhit me atë të informacionit dhe dijes erudite që përcjell. Do të nxijsa edhe koleksionues të tjerë shqiptarë të bëjnë diçka të ngjashme. Janë një pasurim i vlefshëm me informacion si për rrjetin e tyre profesionist ashtu dhe për institucione të ndryshme kulturore e konservuese në vend dhe rajon. Katalogu në fjalë hapet madje me një parathënie mjaft erudite e elegante të shkruar nga studiuesja e nderuar Luçia Nadin, e cila, ndër të tjera, na sjell një përshkrim si të koleksionizmit ashtu dhe të tipit të koleksionistit.

Po përshkrimi juaj për koleksionistët cili do të ishte?

Nuk do të mjaftonte hapësira e dedikuar këtu për të përmendur joshjen që ka shkaktuar një figurë e tillë në letërsinë botërore. Megjithatë, me dëshirën për t'i bërë një homazh të gjithë koleksionuesve, po citoj këtu përshkrimin që na sjell pena dhe shpirti delikat i një prej esteteve më të dashur për mua, Valter Benjamin, i cili në esenë kushtuar artit e figurës së koleksionistit shkruan: «Mes kujtimeve më të bukura të një koleksionisti na shfaqet çasti kur ai ia bef në shpëtim të një libri, për të cilin ndoshta më shumë se një mendim ai ka shprehur hesh-turazi një «urim apo dëshirë të fshehtë» që libri të vijonte mbetjet diku i paprekur, i lënë mbas dore, i pabërë në thelb prej askujt, me qëllim që vetë koleksionisti ynë të mund ta blinte atë, siç ndodh në përrallat e ‘Një mijë e një netëve’, ku princit e blen sklaven e bukur thjeshtë për t'i dhënë asaj lirinë. Në fakt, përfundon Benjamin-i për koleksionistin, liria e vërtetë e të gjithë librave gjendet pikërisht diku në radhët e koleksionit të vet’.



Nga Luçia Nadin*

Kush është një koleksionist? Përgjigja s'mund të jetë veçse e selitur dhe e ndërlikuar, pse sjell në vëmendje universin e njohurive dhe dijes. Një përcaktim i menjëhershëm do ta përkufizonte si dashnor të eksplorimit dhe kërkimit, një i shqetësuar që ndjek kujtesën e kohës ngaherë, një i apasionuar që rreket gjithnjë t'i bëjë materialisht të tija sa më shumë prej vlerave që e kanë zotëruar shpirtërisht e mendërisht më parë atë vetë. Koleksionisti është një "i apasionuar", pse pikërisht me pasion ndërftues në shtigjet e njohjes për të ndjekur gjurmë materiale. Dukuritë tek të cilat synon, nuk i përgjigjen kuptimit thjesht egoist të grumbullimit; qëllimi është të kërkuarit, mbledhurit, rregulluarit, kataloguarit e tok me to është dashuria për të ndërtuar një rrethim të veçantë, të përmuara mbledhjes së objekteve të çmuara. Është pra, para së gjithash, një "udhëtar", në meditim dhe në realitet, i cili më pas i sistemon së bashku frutet e udhëtimit që, përmes tyre, të mund të rrefejë. Është një "rrefimtar" edhe koleksionisti, që përvijon dora-dorës thurimën përmes copëzave të asaj që ka ekzistuar, në kohë dhe në hapësirë, apo të asaj që ekziston: mund të jenë këto segmente, për shembull, një përmblendje botanike, repertorë arkeologjikë, monedha, vepra arti, vula, libra antikë, dorëshkrime. Koleksionisti është gjithnjë një "kuresh-tar", që bëhet ndërtesa *iwunderkammer*, vende të mrekullive ku shtrij gjërat e tij të çmuara, vende që mendohen e organizohen me kri-teret të sakta të strukturës arkitektonike, ku studiohen deri edhe burimet e dritës, për të ngjallur – me këtë rast – me krenarinë e merituar, habinë e vizitorëve.

"Studioli" (ministudio) u quajtën në epokën rilindëse vende të famshme princërore kushtuar artit, ku emblematik ishte ai i Isabel

la d'Este, dhe forma zvogëluese u përdor jo për të nënvizuar idenë e së voglës, porse atë të së mbyl-lurës, të intimes. Nuk i bishtonin një skenari të tillë edhe "studio-lio" e Ylli Sulës. Aty hyhet në majë të gishtave si në skutat më të përkujdesura të një biblioteke, kushtuar këshillimit të dorëshkrimeve antike. Lëviz nga njëri raft tek tjetri në historinë e Shqipërisë, në stinë të sakta historike të ndërtuara deri sot; disa hapësira bosh projektojnë marrje të reja, mëngë të reja për t'u gjurmuar, me të cilat koleksioni do të rritet. Janë rreth 1200 tituj të skeduar, nga 1493 deri në luftën e dytë botërore, të cilat mbulojnë kryesisht tematikat në vijim: stinën e Skënderbeut, historiografinë mbi Madonën e Boun Consiglio-s, koleksionin e veprave të Papa Klementit XI Albani, sektorin e udhëtarëve të huaj që lanë kujtime mbi Shqipërinë, koha dhe raportet politiko-kulturore të Ali Pashë Tepelenës, historinë e gjuhës shqipe, ritet e disa besimeve të praktikuara në Shqipëri, e më tej akoma harta, karta gjeografike, vula.

Një excursus shumë i shkurtër dhe në botën koleksionuese ndoshta do mund t'i japë më mirë peshën e merituar koleksionit të Ylli Sulës; dallohet me vetëdije të plotë se ai është vetëm një dritë e zbehtë e asaj që ka qenë dhe ishte një univers që brenddashkruhet, domosdoshmërisht, në kohën dhe në hapësirën gjeografike europiane.

Koleksionimi lindi në periudhën aleksandrine, me qëllimin e saktë për të ringjallur ideat e Gregjisë antike klasike. Në periudhën e humanizmit, kërkimi i dorëshkrimeve nga orienti i afërt, përfshij Venecian, po aq sa Romën dhe Firencen; të kujtohet së paku Ciriaco d'Ancona dhe udhëtimit e tij në Mesdhe, por edhe emri i Bessarione-s dhe koleksionit të tij të dorëshkrimeve, të cilin ai ia dhuroi pas vdekjes Bibliotekës Marcianit të Venecias, apo emri i Marcianit Pietro Barbo pastaj Papa Pali II, një kërkues i apasionuar i antikës. Në shekullin XVI Venecia bëhet një nyje tregtare shumë e rëndësishme për tregun e antikuarit, tek i cili e kanë

Arkëza e librave të një koleksionisti

burimin koleksionet veneciane, të cilat nisën të gatiteshin pikërisht atëherë dhe krijuan një mit të vërtetë të veçantë; ato të familjes Grimani shenjuan vërtet një epokë.

Në shekullin XVII ishte koleksionimi dinastik që spikati përmes oborreve dhe politikanëve të fuqishëm. Vlen të kujtohet të pak- të Kardinali Mazarino, i cili i lëshoi agjentët e tij nëpër Gjermani, Itali dhe Angli, duke ia dalë mbanë të mblodhë tok më shumë se tridhjetë mijë vëllime në dorëshkrim: më pëlqen të kujtoj se pikërisht në këtë minierë, që më pas i kaloi Bibliotekës Kombëtare të Parisit, tani së fundmi është gjetur dorëshkrimi i Marin Barletit mbi rrethimin e dytë të Shkodrës, të 1478-ës, dorëshkrim që përfaqëson redaktimin e parë të veprës, e cila shkoi më pas për shtyp në 1504. Në vijim të shekullit XVIII të

Vivaldi, duke u lënë pasardhësve vërtet një vlerë të pazëvendësueshme.

Në Venecia pas fundit të Republikës Serenissima në 1797 në tregun e antikuaritit përfundonin pafund sende të rralla të familjeve patrice dhe ishte fat që dashuria e privatëve i shpëtoi, por vetëm pjesërisht, nga bastisjet dhe shpërhapjet: përmblodhjet e tanishme në mjediset e Muzeumit Corrier, ashtu sikurse fondet e dorëshkrimeve Cicogna, na kujtojnë sot kultin pasionant të koleksionit dhe të kërkimit të antikës të një Teodoro Correr dhe të një Emanuele Cicogna. Mes këtyre fondesh u ruajt ai kodi i shenjuar 295, që përmbante Statutet e moçme të qytetit të Shkodrës: një kod, një segment i historisë së rigjetur, dëshmi e një stinë të madhe qytetërimi për Shqipërinë e Mes-

pont Morgan, president i Metropolitan Museum, i cili i dhuroi 40% të veprave që kishte grumbulluar, tek Peggy Guggenheim, që e adresoi në Venecia koleksionin e saj të shkëlqyer të artit, qëllim turistik i pashmangshëm i qdo udhëtimit evropian. Ja pra, qarku virtuoz dhe zhvillim i tij në kohë: një treg anti-kuarësh, koleksionimi privat, trashëgimia muzeale që bëhet një vlerë për të gjithë: një thurimë rrëfyese, me raste e përndarë, që flet për pasionet individësh dhe mecenatësh, që kanë shpëtuar vlera nga moskokëçarja, nga shpërhapja, apo nga rastësia, duke ruajtur çaste të jetës qytetare, historike; ai nuk rrefën thjesht ngjarje personale të një prestigji, apo të një pushteti financiar, por pasionet dhe shtysat për të lëvizur në botën e njohjes, e cila, qysh në fillim, i blatohet Koleksionistit. Një figurë tashmë që ka hyrë në botën e rrefimit, edhe pse e përdorur shpesh në kthesat patologjike, në zhanrin e verdhë, apo në rrefimin filmik dhe fumetik, pasi, nëse për vetë natyrën e tij koleksionisti, sikurse është thënë, është një udhëtar; udhëtimi është edhe rre- zik, edhe eksplorim aventuresk e intrigues, zotëruar nga Fati dhe Rastësia. Që sot në Shqipëri lindin "studioli" të reja të kujtesës rilindëse, në të cilat përmblodhen çaste kyç të historisë së vendit, është një rast kënaqësie e jashtëzakonshme, sidomos për atë që e njeh atë histori dhe fjet e shumta të këputura të saj.

Ja, me të hyrë në dhomën e koleksionit libror të Ylli Sulës në Tiranë të jepet përpara së gjithash ideja se mund të rriqepen, me dokumentim të saktë, me respektim të burimeve të rifituar, ato fije të këputura. Ndërkohë e njëjta sekuençë e plotësuar në rafte, me seksione të ndryshme, të bëhet përshlytje menjëherë. Çdo i ri shqiptar duhet të hyjë për të mësuar dashurinë, respektin dhe "kujdesin" për historinë e vendit të vet: dikush prej tyre mund të dashurohet nga pafundësia e së shkuarës, të zbulojë shijen e prekjës së kartave të moçme, të ketë fatin për "t'u përzgjedhur" nga ndonjëri prej librave në raftet e shumta për t'u bërë një dishepull i ri i pasionit intim të kërkimit.

Është e pëlqyeshme ta gesh këtë dashuri për vendin tënd, sepse Shqipëria sot mund të bëhet një far i ri kulturor dhe kjo, përtej çdo retorike, mund të pohohet me forcë. E siguron këtë kompleksitet i historisë, shfaqur në mijëra mënyra, sikurse lumturisht thosh- te Indro Montanelli në 1939, në të tjuken "Shqipëri, Një dhe një mijë"; duke nisur nga modeli i vendit, nga bashkëjetesa paqësore e kulturave dhe besimeve të ndryshme, një model i jetës qytetare që duhet të vazhdojë të mbrohet dhe të eksportohet.

* (E përktheu Eldon Gjika)



Ekspozita me botime të ralla nga koleksioni i Ylli Sulës

Sovranët, Papët, Princat u bashkuar dora-dorës studiues të veçantë dhe privatë, të cilët udhë- tuan personalisht, apo organizuan udhëtime në kërkim të objekteve të moçme të artit, librave të rrallë, dorëshkrimeve. Edhe në këtë rast vijnë në mendje, veç të tjerëve, dy emra, të lidhur me Shqipërinë. I pari është ai i Papa Klementit XI, nga familja Albani, që projektoi një enciklopedi të madhe lidhur me Ilirinë, koleksionit i apasionuar i veprave të artit dhe i koleksioneve numizmatike. Është fakt i mirënjohur se sa shumë e ka mbështetur ai vëllim i jashtëzakonshëm të dhënash shkrimore në dorëshkrime punën e Riceputi-t, Farlati-t e Colet-i, që të mbërrinin më pas në hartimin e të shumëçmuarës *Illyricum Sacrum*. Emri i dytë është ai Giacomo Durrazo-s (dihet, me origjinë shqiptare, dinastia e njohur gjenoveze), që si privat grumbulloi koleksione shumë të çmuara porcelani, mobilijesh, tablos, vullash; mblodhi, duke i shpëtuar nga zhdukja, bashkësinë e partiturave muzikore të të madhit Antonio

jetës së vonë. Ja, pra, forca revolucionarizuese e burimeve të rigjetura të së shkuarës, ja sesi një kodth me pak faqe mund të shpërfaqë njohjen e shekujve. Në të njëjtën mënyrë një hartë e vjetër, apo një portik antik, me toponomastikën e tyre, bëhen miniera informative mbi të shkuarën. Këtë e di fare mirë çdo koleksionist i vërtetë. Mes shekujve XIX dhe XX është pothuajse e pamundur ta rrokësh panoramën e pamatë të koleksionistëve privatë të kombësive të ndryshme dhe të arrish të dëshmosh funksionin shpëtimtar të së shkuarës, të cilin në shumë raste ata e kryen duke ua lënë institucionet publike, në mënyrë testamentare, trashëgiminë e vlerave që kishin mblodhur. Është e detyrueshme në këtë rast të theksohet rëndësia e një areali jashtë-europian, duke sjellë në kujtesë personazhet e famshëm amerikanë, të cilët që nga gjysma e tetëqindës e në vijim, renden të "bastisin" Europën, koleksionet private të të cilëve janë bërë sot qendra muzeale të famshme, të hapura për kënaqësinë e publikut. Që nga Reed a Bryan në Jarves deri në Pier-

Argentinasi është gati të luftojë për postin e titullarit

Dibala: Te Juvja vetëm Ronaldo e ka vendin të sigurt

Paulo Dibala është i ndërgjegjshëm se do t'i duhet që të paraqitet në vazhdimësi si të martën ndaj Manchester Junajtid nëse dëshiron që të jetë protagonist me fanellën e Juventusit, pasi afrimi i Kristiano Ronaldos ka ndryshuar disa gjëra. Argentinasi e ka parë veten shpesh në stol që me afrimin e por-

tugezit dhe është i sinqertë kur pranon që vetëm Ronaldo e ka vendin të sigurt, ndërsa të tjerët duhet të bëjnë rotacion duke vënë jo pak në vështirësi trajnerin Alegri. "Mua nuk më peshonte shumë situata, kam qenë gjithmonë i qetë, kam vazhduar të punoj në heshtje dhe të bëja si gjithmonë gjërat e mia. Tani që erdhën golat,



duhet të qëndroj i qetë dhe të vazhdoj kështu", tha ai për "Tuttosport". "Kristiano është ai që e ka vendin e sigurt në skuadër, pastaj të tjerët jemi shumë që luftojmë për një fanellë. Varet nga sistemi i lojës, nëse është me një apo me dy sulmues, edhe për Alegri nuk është e lehtë. Nëse luaj apo jo, do të varet nga unë", tha Dibala.

Perez e kishte ndarë mendjen

Drejtori sportiv shpëtoi Lopeteguin nga shkarkimi

Presidenti i Real Madridit, Florentino Perez kishte për qëllim të ftonte në një takim trajnerin Julen Lopetegui para ndeshjes kundër Barcelonës, për t'i bërë të ditur vendimin e tij për ta shkarkuar. Por drejtori sportiv i madrilënëve, Hoze Anhel Sanchez, bindi Perezin që të mos e shkarkojë Lopeteguin nga detyra para "El Clasicos", pasi kjo do të dëmtonte shumë lojtarët dhe skuadrën. Kështu raportoi "El Confidencial", e cila zbuloi planin e presidentit Perez. Përplasja e Real Madrid kundër Barcelonës është planifikuar për në 28 tetor. Aktualisht Barcelona është në vend të parë me 18 pikë, ndërsa Real Madridi është në krizë, pasi ndodhet në vend të shtatë me vetëm 14 pikë

Trajneri i të kuqeve dhe drejtori Rama nuk falin sjelljen e pajustificuar të gramshakut

Gega ndëshkon Lorenc Trashin, jashtë skuadre ndaj Skënderbeut

Mesfushori nuk paraqitet në stërvitje, gjobitet



Jeton Selimi

Partizani udhëheq me meritë kampionatin, është skuadra që ka bindur më shumë në këtë fazë të parë të superligës, por humori në shtëpinë e kuqe nuk është ai i duhuri, kjo sepse te kryeqytetasit ka një çështje të nxehtë, ajo që i takon Lorenc Trashit, mesfushorit që në ndeshjen ndaj Luftëtarit u largua nga stadiumi "Selman Stërmasi" i nxirre në fytyrë dhe nuk bëri pas pavarësisht thirrjeve të drejtorit Olsi Rama. Kjo ka turbulluar ujërat te Partizani, që në prag të ndeshjes së rëndësishme ndaj Skënderbeut, duhet të menaxhojë një situatë aspak komode. Ajo që ka habitur pa masë drejtuesit kryeqytetas ka qenë reagimi anormal i gramshakut, i cili në ndeshjen ku të kuqtë triumfuan 2-1 ndaj Luftëtarit, ishte edhe kapiteni i skuadrës në vend të të dëmtuarit Alban Hoxha. Madje pak përpara atij takimi, Partizani zyrtarizoi edhe kontratën e re me Trashin, që ka pranuar të zgjasë kontratën deri në vitin 2020 me një rritje të ndjeshme të pagës. Gjithashtu, në këtë sezon të kuqtë po bëjnë lobing të fortë për mesfushorin e tyre, të cilit po i mbyllet dera në vazhdimësi nga Kristian Panuçi, ndërsa SportNews mëson ekskluzivisht se po bisedohet me disa klube të huaja, për t'i mundësuar Trashit një aventurë jashtë vendit, një ëndërr e vjetër e



lojtarit. Parë këtë situatë, është vërtet e pakuptimtë ajo sjellje, ndërsa e vetmja pistë mbetet ajo e ndryshimit të pozicionit nga mesfushor në mbrojtës të majtë, por ka qenë vetë Trashit që pak kohë më parë e ka bekuar këtë lëvizje, duke i dhënë të drejtë trajnerit Gega. Gjithsesi duket e zorshme që në këtë situatë

lojtari të shpëtojë pa ndëshkuar, ndërsa veç gjobës së majme pritet edhe degdisja e lojtarit te Partizani B, vendim ky pa një afat të caktuar, që mund ta lërë mesfushorin jashtë ekipit të parë për një kohë të gjatë. Si për ta shtuar edhe më shumë turbullirën në këtë çështje, janë edhe mungesat radhazi të Trashit në stër-

vitje, pasi as dje mesfushori nuk është paraqitur në apel. E sigurt është që gramshaku ka humbur takimin ndaj Skënderbeut, ndërsa mbetet për t'u parë se çdo të ndodhë, ndonëse dihet se drejtori Rama dhe trajneri Gega në çështjet disiplinore janë në një mendje dhe zor se bëjnë pas në një situatë të tillë, pa-

SUPERLIGA		
JAVA E 10-të		
TË SHTUNËN		
Kamza - Tirana		14:00
Flamurtari - Teuta		17:00
TË DIELEN		
Kastrioti - Luftëtar		14:00
Laçi - Kukësi		14:00
TË HENËN		
Partizani - Skënderbeu		19:00
RENDITJA		
Skuadra	N	P
Partizani	9	22
Skënderbeu	9	20
Laçi	9	16
Kukësi	9	16
Teuta	9	14
Flamurtari	8	11
Tirana	8	8
Kamza	9	7
Luftëtar	9	6
Kastrioti	9	4

varësisht rëndësisë së madhe që ka Trashit në skemat e Partizanit.

FLAMURTARI



Daja buzëqesh, rikthehen Sirghi dhe Alla

Pasi mundën Tiranën 1-0 në Vlorë, vlonjatët kanë mundësinë më të mirë për të marrë 3 pikët e radhës, ndonëse përballë do të kenë sërish një kundërshtar të fortë dhe mjaft në formë, Teutën e Durrësit. Skuadra e trajnerit Iliri Daja, në këtë sfidë do të jetë më e plotë, pasi janë gati edhe dy lojtarë të rëndësishëm. Bëhet fjalë për Kristian Sirghi dhe Albi Alla, të cilët janë dy forca me shumë për sfidën me bregdetarët në dispozicion të trajnerit Iliri Daja. Por, Flamurtari tashmë mund të rifutet në garën për kreun sepse edhe kalendari është në favor të kuqezinjve, pasi luajnë ndeshjen e dytë në fushën e tyre pas asaj me Tiranën dhe grupi është në një gjendje shumë të mirë morale dhe psikologjike. Tri pikët me Teutën nëse realizohen, e bëjnë Flamurtarin edhe më shumë solid për transfertën me Kukësin e cila do të luhet në fushë neutrale. Ndaj edhe Flamurtari ka mundësinë më të mirë që të mposhtë durrsakët, pasi luan një ndeshje që vlen shumë.

UEFA ka miratuar fondin për klubet e Europa League, tekta tashmë në llogaritë e klubeve do të kalojnë përfitimet për sezonin 2017/18. Në mes të klubeve që përfitojnë është edhe Skënderbeu, që mori pjesë në grupet e këtij kompeticioni. Shuma që shkon në arkat e klubit korçar është 3,748,961 euro. Plot 2.6 milionë euro korçarët i përfituan nga kualifikimi në fazën e grupeve. Veç kësaj, 500,961 euro të tjera bardhekuqtë i morën të gjitha vetë, pasi ishin i vetmi klub shqiptar në fazën e grupeve.

Fitimet nga Europa League janë 3.7 milionë euro

UEFA mbulon me ar Skënderbeun, por pritet KAS-i

Rezultatet e arritura i dhanë edhe 648,000 euro Skënderbeut. Skuadra e drejtuar asokohe nga Ilir Daja mori dy barazime dhe një barazim. Korçarët barazuan me Jang Bojs dhe Partizanin e Beogradit në "Elbasan Arena", si dhe mundën Dinamon e Kievit. Gjithsesi nuk dihet nëse


UEFA nga kjo shumë do të mbajë gjobën prej 1 milion eurosh që ka vendosur për korçarët. Sikurse dihet, përveç gjobës, qeveria europiane e futbollit ka vendosur që korçarët të mos marrin pjesë për 10 vite në kompeticionet evropiane dhe tashmë çështja është në KAS.

Daljet vonë nëpër klube, paralajmërohet Hoxha

Por jo vetëm Trashit. Edhe kapiteni Alban Hoxha ka qenë në qendër të kritikës nga ana e drejtuesve të klubit. Portieri i Komitëtarës dhe kapiteni i ekipit të kuq është fotografuar natën vonë duke festuar në një nga klubet e kryeqytetit pas fitores ndaj Luftëtarit, çka nuk ka kaluar pa rënë në sy të drejtuesve, që e kanë paralajmëruar lojtarin të shmangë daljet në orët e vona dhe aq më tepër publikimin e tyre, pasi është kapiteni i ekipit më popullor në vend dhe imazh për shumë të rinj. Kësaj radhe Hoxha ja ka hedhur paq, por herës tjetër natyrisht që e pret gjoba.



Fjalëkryqi (1)



- 35. Është legjenda
- 36. Kështu thirrje Marco Pantani.
- 38. Lindsay aktore.
- 40. Kaplon të inatosurin.
- 42. Janë edhe ato të cirkut
- 44. Është numri i oktetit
- 45. Fillojë armataimin.
- 46. Janë pasuri të investuara.
- 47. Është shoshë.

VERTIKAL

- 1. Një spektakël me dema.
- 2. Negri poete.
- 3. Kështu e ka punën ai që e ka kuj
- 4. Konak pa kufij
- 5. Fillojnë nismat.
- 6. Ishin kaçakë.
- 8. Është pika delikate
- 9. Mali ku ngeci Arka.
- 10. Zanicchi këngëtare.
- 12. Janë shoferë të Formula 1.
- 13. Gironë aktor.
- 16. Janë trarë.
- 17. Ulen në dhomën e lartë.
- 18. Janë sandale lëkurëkuqsh.
- 20. Dhjetë angleze.
- 21. Gënjejnë për t'u bërë të famshëm.
- 22. Emri i Bismarck.
- 24. Gjysma e leqeve.
- 26. Janë katalizatorë të organizmit.
- 31. Duhet vaditur.
- 32. Kutia kur nuk... ka
- 33. Kush është... është në moshën e tretë.
- 34. D'Istria, alias Elena Gjika.
- 36. Sampras tenist.
- 37. Marsi i akejve.
- 39. Një pjesë e hepatiti.
- 41. Firar pa kufij
- 43. Fillojnë tatëpjetën.

HORIZONTAL

- 1. Një Ai famëkeq.
- 7. Është mjet lundrimi klandestinësh.
- 11. Ishte kryepërndi nordike
- 12. Një pjesë e porosive.
- 14. Inicialet e Redford.
- 15. Mund të jetë emërore.
- 16. Është vegetacion.
- 18. Shkruhet shkurt mm.
- 19. Inicialet e Turgeniev.
- 21. Është e mërzitshme.
- 23. Kështu thomë së është femra
- 25. Janë pjesë drame.
- 27. Kanë aderuar në parti.
- 28. Fillojnë teorinë.
- 29. Nikola Tesla.
- 30. Nuk kanë nevojë të rruhen.
- 31. Derek aktore.
- 32. Një pije aromatike
- 33. Pierre Daninos.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- 1. Arbana aktor.
- 7. Kështu janë enigmat.
- 13. Bëjnë shumë të tilla fëmijët zevzekë.
- 15. Ishtë familja e Henrikut VII.
- 16. Fund filmi.
- 17. Opera me Liu dhe Calaf.
- 19. Fillojnë një motiv
- 20. Është gjuhë si çiftja.
- 21. Bëhen në stacione.
- 23. Fillojnë romanin
- 24. Është policia e FBI.
- 26. Të parat në stacion.
- 27. Mund të jepet me medalje.
- 28. Inicialet e Keaton aktore.
- 29. Dënosheshin nga Inkuizicioni të tillë.
- 31. Zanore për papare.
- 32. Fitohen nga çiklistët.
- 33. Me beach në një qytetë të Florida-s.

VERTIKAL


- 35. Shigjeta e argjendte e Formula 1.
- 37. Është shërbimi me letra
- 39. Inicialet e Asimov.
- 40. Një rreth pa ekstreme.
- 41. Është syzë në komodinë.
- 42. Ndezur përgjysmë
- 44. Janë dilatantë.
- 45. Memoria në computer.
- 46. Janë engjëjt të Korit të lartë.
- 8. Janë mdenjëse në park.
- 9. Është mbikëqyrje ndaj të miturit.
- 10. Harris aktor.
- 11. Qyteti i përjetshëm.
- 12. Janë filmat me drita të kuqe.
- 14. Tigr i Malajzisë i Emilio Salgarit.
- 16. Ai i Mach u udhëhoq nga Mao Ce Dun.
- 18. Është vegël e... rrethimit.
- 22. Fillojnë sefte.
- 24. Janë besimet e besimtarëve.
- 25. Janë skuadra.
- 27. Janë linjat me tragete.
- 28. I preu Seneka.
- 30. Një pjesë e relacioneve.
- 31. Janë vendet ku prehen heronjtë.
- 33. Është detar si ai i Durrësit.
- 34. ... Villa në futbollin anglez
- 36. Loriku kuqezi.
- 37. Edith e La vie en rose.
- 38. Një mund të jetë fetar.
- 41. Janë tek në samba.
- 43. Bëjnë durim me uri.
- 44. Në krye të armatës.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

D	A	V	I	D	R	O	C	K	L	K	R
E	M	E	R	K	E	A	S	E	A	N	A
M	A	L	O	T	K	E	N	E	T	A	T
I	N	N	I	M	R	O	M	A	N	E	T
R	R	P	A	S	I	V	E	T	T	M	
M	O	K	A	S	I	N	A	I	D	E	M
E	M	I	K	A	I	A	V	A	T	I	
S	T	A	N	E	A	T	O	M	I	K	N
A	R	S	T	R	E	T	E	O	D		
A	A	S	E	M	I	K	O	R	E		
A	T	A	T	A	K	A	T	I	D	A	R
H	S	T	A	R	S	I	R	T	A	R	I

FJALËKRYQI (2)

B	A	L	E	N	A	A	M	M	O	T	I
E	N	K	A	G	A	L	U	M	A		
K	T	M	I	K	R	K	A	R	A	T	E
I	T	P	A	L	E	T	L	I	R	A	
M	A	T	P	E	T	A	L	E	T	M	R
I	A	M	A	K	E	T	E	T	K	O	T
K	A	L	K	U	L	I	M	E	T	R	E
M	U	L	E	R	M	E	T	A	L	E	
A	N	B	E	T	A	I	R	P	O	T	
N	A	I	F	P	I	A	E	I	D	E	
E	T	J	E	M	I	N	A	T	O	R	E
T	I	T	R	E	N	I	A	F	A	T	I

SUDOK

7	9			1	3		2
			7			9	
6	1	3					
1	7		6	2	5		9
9	8		7			2	5
	5	2			8	6	
5		7	2				6
			4			5	7
		8					

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

7	8	5	2	1	4	9	3	6
2	9	3	6	8	5	7	4	1
1	4	6	3	7	9	8	5	2
8	2	1	4	3	6	5	9	7
9	5	4	8	2	7	6	1	3
3	6	7	5	9	1	2	8	4
4	3	8	9	6	2	1	7	5
5	1	2	7	4	8	3	6	9
6	7	9	1	5	3	4	2	8

Argëtim filozofik

- Çdokush mund të zemërohet, është e lehtë, por të zemëroresh me njeriun e duhur në momentin e duhur dhe me qëllim e duhur, dhe në mënyrën e duhur, kjo nuk është në fuqinë e askujt dhe nuk është aspak e lehtë (Aristoteli)
- Graviteti nuk është përgjegjës që njerëzit bien në dashuri. Si mundet ta shpjegojmë në terma kimikë dhe fizikë një fenomen kaq të rëndësishëm sa dashuria e parë? Vendose dorën mbi furinë për një moment dhe të duket si një orë. Ulu me një vajzë speciale për një orë dhe të duket si një minutë. Ky është relativiteti (Albert Einstein)

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

12	3	9	6	1	10	18	2	4	11	5	1
4	2	6	9	12	3	3	2	6	2	4	
15	8	4	7	5	1	5	1	1	11	14	
8	4	2	6	1	5	1	6	1	6	9	
8	4	1	6	13	3	2	6	11	7	6	
5	15	18	18	13	3	12	6	2			
2	1	7	14	2	2	6	1	7	14	6	
10	6	7	6	6	5	1	3	8	6	1	
6	1	4	1	12	10	6	6	6	7		
7	11	6	5	5	7	6	2	1	5		
7	L	1	1	5	1	6	7	5	14	1	5
5	6	1	1	2	4	1	5	11	5		

A	P	A	P	E	K	E	N	D	E	T
D	I	A	B	E	T	I	D	E	T	I
R	A	K	L	K	A	P	E	L	E	T
F	F	E	N	I	M	O	R	E	T	R
F	E	K	O	N	O	M	I	A	D	
R	A	T	A	K	E	M	E	T	P	E
A	N	T	E	N	A	T	A	B		
N	A	N	T	E	S	T	L	A	R	A
K	N	E	I	L	I	R	E	T		
I	B	A	N	A	K	A	E	T		
B	A	R	I	A	L	E	T	N	E	D
E	B	A	S	T	I	A	F	A	T	I

Thënie të mençura

- Asnjë s'mund të të bëjë të ndihesh inferior pa lejen tënde (Eleanor Roosevelt)
- I fortë është ai që është në gjendje të kap çdo komunikim mes shqisave dhe mendjes (Napoleon Bonaparte)

- Njerëzit e mirë nuk kanë nevojë për ligje për t'itreguar atyre të veprojnë me përgjegjësi, ndërsa njerëzit e këqij do ta gjejnë një mënyrë për të thyer ligjet (Platoni)
- Ajo që nuk më vret më bën më të fortë (Friedrich Nietzsche)

